



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË
SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

UDHËZUES PËR ZHVILIMIN E KURRIKULËS ME KOMPETENCA TË ARSIMIT FILLOR

Material në ndihmë të mësuesit

2023

Hartues të udhëzuesit

Dr. Aurela Zisi

Dr. Edlira Sina, Mezini

Koordinoi redaktimin shkencor

Dr. Dorina Rapti

Koordinoi redaktimi letrar

Elfrida Begaj

Koordinoi faqosjen

Fatos Gjini

Prodhim i ASCAP, 2023

www.ascap.edu.al

Copyright ©, ASCAP

PËRMBAJTJA

1	QËLLIMI I UDHËZUESIT	6
2	PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR.....	7
3	ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET FUSHAVE TË TË NXËNIT	10
4	KOMPETENCAT DHE TEMATIKAT E FUSHAVE TË TË NXËNIT.....	11
4.1	FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI.....	11
4.2	FUSHA/ LËNDA: MATEMATIKË.....	13
4.3	FUSHA: SHKENCAT E NATYRËS	13
4.4	FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI.....	14
4.5	FUSHA: ARTET.....	15
4.6	FUSHA: EDUKIMI FIZIK, SPORTET DHE SHËNDETI.....	17
4.7	FUSHA: TEKNOLOGJI DHE TIK	18
4.8	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE	19
5	PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES.....	20
5.1	Llojet e planifikimeve	20
5.2	Planifikimi vjetor i lëndës	21
5.3	Planifikimi i tri periudhave	22
5.4	Planifikimi ditor	25
5.5	Planifikimi i kurrikulës në bazë shkolle.....	30
6	VLERËSIMI I NXËNËSIT NË ARSIMIN FILLOR	31
6.1	Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III.....	33
6.2	Vlerësimi i nxënësit në klasat IV dhe V	36
6.3	Vlerësimi periodik i nxënësit	37
6.3.1	Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë).....	38

6.3.2	Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse.....	39
6.3.3	Vlerësimi me projekt kurrikular.....	41
6.3.4	Planifikimi i projektit.....	43
6.3.5	Vlerësimi i projektit	44
6.3.6	Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi	50
6.4	Plotesimi i vlerësimit periodik në regjistër	51
6.5	Nota përfundimtare vjetore	51
6.6	Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar	52
7	DREJT NJË MËSIMDHËNIEJE EFEKTIVE.....	53
8	LLOJET E PYETJEVE SIPAS NIVELIT TË TYRE.....	65
8.1.1	Përparësitë e përdorimit të metodave ndërvepruese	68
8.1.2	Roli i mësuesit gjatë përdorimit të metodave ndërvepruese në procesin mësimor	68
8.1.3	Roli i nxënësit gjatë përdorimit të metodave ndërvepruese në procesin mësimor	68
9	TESTET	73
9.1	Parimet e hartimit të testeve.....	73
9.2	Hartimi i testit	75
10	PËRGATITJA E NXËNËSVE PËR VANAF	79
10.1	GJUHË SHQIPE.....	81
10.2	MATEMATIKË.....	87
10.3	DITURI NATYRE.....	93
11	SHTOJCA – MODEL PROJEKTI	100

Ndryshimet në shoqëri kërkojnë ndryshime në mësimdhënie dhe në të mësuarit... Mësimdhënia ndodh vetëm kur nxënësit ndryshojnë...



“Mësuesit që dinë diçka për procesin e të mësuarit, nuk mund t’i rezistojnë angazhimit në sfidën intelektuale, për të parë nëse mund ta përmirësojnë efektin e mësimdhënies së tyre mbi të mësuarit e nxënësve” (Cross,K.P)

1 QËLLIMI I UDHËZUESIT

Udhëzuesi për zbatimin e kurrikulës me kompetenca synon t'u vijë në ndihmë mësuesve dhe drejtuesve të arsimit fillor, si dhe drejtuesve të rrjeteve profesionale.

Në këtë dokument, mësuesit dhe drejtuesit gjejnë:

- udhëzime dhe sqarime për planifikimin dhe zbatimin e kurrikulës,
- udhëzime për vlerësimin e nxënësve,
- udhëzime për kuptimin e temave ndërkurrikulare,
- udhëzime për planifikimin, zhvillimin dhe vlerësimin e projekteve etj.

Ky udhëzues u shërben specialistëve të arsimit dhe drejtuesve për të monitoruar ose për të mbështetur mësimdhënien në këtë cikël shkollimi, si edhe prindërve për qëllime informimi.

Udhëzuesi i shërben:

- *Mësuesve* për planifikimin, realizimin dhe vlerësimin e procesit mësimor dhe të arritjeve të nxënësve.
- Drejtuesve të shkollave për t'u njohur me specifikat e punës në arsimin fillor.
- *Specialistëve të arsimit* për të monitoruar dhe për të mbështetur mësuesit dhe shkollat.
- *Prindërve* për njohjen e rezultateve të pritshme të fëmijëve dhe të kritereve të vlerësimit në periudha të caktuara përgjatë vitit akademik.

2 PLANI MËSIMOR PËR ARSIMIN FILLOR

Plani mësimor është një dokument i rëndësishëm, i cili orienton shkollën për organizimin e procesit mësimor, në nivel shkolle, shkalle dhe klase.

Në planin mësimor përcaktohen:

- fushat e të nxënit dhe lëndët për secilën shkallë;
- shpërndarja e lëndëve përgjatë shkallëve;
- numri i orëve javore për secilën klasë.

Në tabelën 1 është pasqyruar vetëm plani mësimor i kurrikulës arsimit fillor, i cili është pjesë e planit të arsimit bazë (klasat 1-9).

Tabela 1. Plani mësimor i arsimit fillor (URDHËR NR.203, DATË 25.04.2023 MIRATIMI I PLANIT MËSIMOR TË ARSIMIT BAZË)

Nr.	FUSHA/LËNDËT	KLASAT					GJITHSEJ
		Shkalla 1		Shkalla 2			
		I	II	III	IV	V	
1	GJUHËT DHE KOMUNIKIMI	10	10	9	8	8	45
1.1	Gjuhë shqipe	8	8	6	5	5	32
1.2	Gjuhë e huaj e parë ANGLISHT	2	2	3	3	3	13
2	MATEMATIKA	4	4	4	4	4	20
3	SHKENCAT E NATYRËS	1	1	1	2	2	7
3.1	Dituri natyre	1	1	1	2	2	7
4	SHOQËRIA DHE MJEDISI	1	1	1	2	2	7
4.1	Edukim për shoqërinë	1	1	-	-	-	2

¹Shkalla I e kurrikulës përfshin dhe nis me vitin përgatitor, moshën 5-6 vjeç. Ky udhëzues është hartuar për të ndihmuar mësuesit e arsimit fillor në zbatimin e kurrikulës me kompetenca.

4.2	Qytetari	i	i	1	1	1	3
4.3	Histori	i	i	-	1	1	2
5	ARTET	2	2.5	3	2	2.5	12
5.1	Muzikë	1	1	1	1	1	5
5.2	Art pamor	1	1	1	1	1	5
5.3	Kërcim	-	0.5	1	-	-	1.5
5.4	Teatër	-	-	-	-	0.5	0.5
6	EDUKIMI FIZIK, SPORTET DHE SHËNDETI	3	3	3	3	3	15
7	TEKNOLOGJIA DHE TIK-U	0	0	0	2	2	4
7.1	TIK	-	-	-	1	1	2
7.2	Aftësim teknologjik praktik	-	-	-	1	1	2
8	KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE	1	1	1	1	1	5

3 ZHVILLIMI I KOMPETENCAVE KYÇ NËPËRMJET FUSHAVE TË TË NXËNIT

Kompetenca përcaktohet si integrim i njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve që një nxënës duhet t'i fitojë gjatë procesit të nxënies. Organizimi i mësimit me bazë kompetencat përqendrohet në atë që nxënësi duhet të dijë, të bëjë saktë dhe të shpjegojë pse e bën.

Kur nxënësi realizon kompetencat lëndore, ai njëkohësisht është duke zhvilluar edhe kompetencat kyç. Ndërtimi dhe zhvillimi i kompetencave kyç nga nxënësit gjatë procesit të mësimdhënies dhe nxënies kërkon që mësuesi të mbajë parasysh lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës për secilën shkallë. Për të realizuar në praktikë këtë lidhje, mësuesi duhet të përzgjedhë situatat, veprimtaritë, metodat dhe mjetet e përshtatshme të procesit të të nxënit.

Për të realizuar lidhjen e kompetencave kyç me kompetencat e lëndës, mësuesi ndjek hapat e mëposhtme:

- *përzgjedh rezultatin/et e të nxënit* nga kompetencat kyç që synon të arrijë nxënësi në shkallën përkatëse dhe e/ i zbërthen atë/ato;
- *përzgjedh rezultatin/et e të nxënit* për shkallë për kompetencat e lëndës që synon të arrijë nxënësi;
- *zbërthen në rezultate të nxëni* për kompetencat e lëndës për vit mësimor, rezultatin/et e të nxënit për shkallë;
- *përzgjedh përmbajtjen mësimore*, mjetet didaktike, metodologjinë e mësimdhënies, përmes të cilave realizohen rezultatet e të nxënit të kompetencave lëndore në një vit mësimor, si dhe rezultatet e të nxënit për kompetencat kyç në një vit mësimor;
- *planifikon mësimdhënien* duke përfshirë periudhën kohore gjatë së cilës do t'i arrijë rezultatet e të nxënit brenda vitit shkollor;
- *kryen analiza dhe vlerësime të ecurisë së nxënësve* pas realizimit të orëve mësimore, detyrave, projekteve, për të verifikuar arritjet e rezultateve të të nxënit për vit mësimor dhe shkallë për lëndët në ciklin fillor.

4 KOMPETENCAT DHE TEMATIKAT E FUSHAVE TË TË NXËNIT

Në arsimin fillor zhvillohen **13 lëndë mësimore**, të përmbledhura në **7 fusha të nxëni**. Secila fushë ka kompetencat e saj. Përmbushja e rezultateve të tyre realizohet nëpërmjet përmbajtjes, e cila në disa lëndë jepet brenda kompetencave të fushës dhe në disa lëndë jepet sipas tematikave.

Programet mësimore të arsimit fillor kanë të njëjtën strukturë dhe rubrika për çdo lëndë. Në mënyrë të përmbledhur, në vijim jepen kompetencat, tematikat dhe numri i orëve për secilën klasë sipas lëndëve përkatëse. Numri i orëve për çdo lëndë mund të lëvizë nga njëra tematikë në tjetrën me fleksibilitet deri në 10% të orëve që përmban secila prej tyre.

4.1 FUSHA: GJUHËT DHE KOMUNIKIMI

Tabela 2. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Gjuhë shqipe

Kompetencat	Tematikat	Shpërndarja e orëve sipas klasave				
		I	II	III	IV	V
Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullat e të dëgjuarit • Të dëgjuarit për të kuptuar dhe për të vlerësuar tekstin 	10	10	10	5	5
Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar	<ul style="list-style-type: none"> • Rregullat dhe organizimi i të folurit • Diskutimi dhe bashkëveprimi në grup 	10	10	10	5	5
Të lexuarit e teksteve të ndryshme	<ul style="list-style-type: none"> • Të lexuarit fillestar (klasa I-III) • Të lexuarit për të kuptuar • Të lexuarit e teksteve letrare • Të lexuarit e teksteve joletrare 	160	150	95	75	75

Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale	<ul style="list-style-type: none"> • Shkrimi i dorës • Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit • Të shkruarit për qëllime personale • Të shkruarit për qëllime funksionale 	70	60	35	30	30
Përdorimi i drejtë i gjuhës	<ul style="list-style-type: none"> • Sintaksë • Morfologji • Leksikologji dhe semantikë • Drejtshkrim • Fonetikë dhe fonologji 	30	50	60	60	60

Tabela 3. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Gjuhë e huaj

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Gjuhësore; • Socio-gjuhësore; • Pragmatike. 	Formimi kulturor	30	30	42	42	42
	Gramatika	15	15	32	32	32
	Funksionet gjuhësore	15	15	21	21	21
	Portofoli evropian i gjuhëve	10	10	10	10	10

4.2 FUSHA/ LËNDA: MATEMATIKË

Tabela 4. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Matematikë

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Zgjidhja e situatës problemore; • Arsyetimi dhe vërtetimi matematik; • Të menduarit dhe komunikimi matematik; • Lidhja konceptuale; • Modelimi matematik. 	Numri	86	77	77	75	70
	Matja	25	28	28	25	23
	Gjeometria	13	24	24	24	22
	Algebra dhe funksioni	3	3	3	4	4
	Statistika dhe probabiliteti	13	8	8	12	11
	<i>Orë përgatitje për provimin e VANAF-it</i>	-	-	-	-	10

4.3 FUSHA: SHKENCAT E NATYRËS

Tabela 5. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Dituri natyre

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre; • Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore; • Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës. 	Diversiteti	17	5	7	5	-
	Ciklet	5	-	-	5	37
	Sistemet	-	11	20	28	10
	Ndërveprimet	7	19	8	15	-
	Energjia	6	-	-	17	23

4.4 FUSHA: SHOQËRIA DHE MJEDISI

Tabela 6. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Edukim për shoqërinë (klasat 1-2), Qytetari (klasat 3-5)

Kompetenca shoqërore dhe qytetare	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Personale; • Ndërpersonale; • Ndërkulturore. 	Individët, grupet, shoqëria	20	20	7	14	12
	Kultura	-	-	7	8	8
	Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi	7	7	7	7	9
	Pushteti, autoriteti, qeverisja	8	8	14	6	6

Tabela 7. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Histori

Kompetencat historike	Tematika	Klasa IV	Orë	Klasa V	Orë
<ul style="list-style-type: none"> • Kërkimi historik; • Përdorimi i burimeve; • Analiza shkak-pasojë; • Interpretimi historik; • Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën. 	<ul style="list-style-type: none"> • Proceset historike, koha, ndryshimi dhe vazhdimësia 	<ul style="list-style-type: none"> • Historia ime dhe e familjes sime 	11	<ul style="list-style-type: none"> • Historia dhe burime 	11
		<ul style="list-style-type: none"> • Lojërat, argëtimet, festat dhe festimet 	6	<ul style="list-style-type: none"> • Shoqëritë e para njerëzore 	12
		<ul style="list-style-type: none"> • Mite dhe legjenda 	4	<ul style="list-style-type: none"> • Qytetërimet antike, themeli i kulturës evropiane 	12
		<ul style="list-style-type: none"> • Zona dhe vendi im 	14		

4.5 FUSHA: ARTET

Tabela 8. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Muzikë

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi muzikor; • Performimi/interpretimi muzikor; • Vlerësimi i veprave muzikore. 	Gjuha dhe komunikimi muzikor	6	8	8	8	8
	Teknika dhe procese muzikore	24	22	22	22	22
	Historia, muzika dhe shoqëria	5	5	5	5	5

Tabela 9. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Art pamor

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi artistik; • Performimi artistik; • Vlerësimi artistik. 	Gjuha dhe komunikimi artistik	10	10	10	10	10
	Teknika dhe procese artistike	20	20	19	19	19
	Historia, arti dhe shoqëria	5	5	6	6	6

Tabela 10. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Kërcim

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
• Krijimi nëpërmjet lëvizjeve;	Gjuha dhe komunikimi i kërcimit	-	5	7	-	-
• Performimi/ interpretimi i lëvizjeve dhe i kërcimit;	Teknika dhe procese të kërcimit	-	10	23	-	-
• Vlerësimi i lëvizjeve dhe i kërcimeve.	Historia, kërcimi dhe shoqëria	-	3	5	-	-

Tabela 11. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Teatër

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
• Krijimi i veprave teatrore;	Gjuha dhe komunikimi teatror	-	-	-	-	6
• Interpretimi i veprave teatrore;	Teknikat dhe proceset teatrore	-	-	-	-	8
• Vlerësimi i veprave teatrore.	Historia, teatri dhe shoqëria	-	-	-	-	4

4.6 FUSHA: EDUKIMI FIZIK, SPORTET DHE SHËNDETI

Tabela 12. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Edukim fizik, sporte dhe shëndet

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i aftësive lëvizore në përshtatje me situata lëvizore e sportive të ndryshme; • Ndërveprimi me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive; • Përshtatshmëria me një stil jete aktiv e të shëndetshëm. 	Edukim nëpërmjet aktiviteteve fizike	45	45	45	40	40
	Aktivitete sportive	35	35	35	45	45
	Praktikim aktiviteteve në shërbim të komunitetit, mirëqenies dhe shëndetit	25	25	25	20	20

4.7 FUSHA: TEKNOLOGJI DHE TIK

Tabela 13. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: TIK

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Kreativiteti dhe inovacioni; • Komunikimi dhe bashkëpunimi; • Kërkimi dhe gjetja e informacionit; • Mendimi kritik, problem-zgjidhja dhe vendimmarrja; • Mbrojtja. 	Bota e kompjuterit	-	-	-	8	8
	Përpunimi digjital i të dhënave	-	-	-	9	9
	Kreativiteti dhe programimi	-	-	-	7	7
	Përpunimi digjital i të dhënave dhe prezantimit	-	-	-	7	7
	Siguria në internet dhe siguria e të punuarit në kompjuter	-	-	-	4	4

Tabela 14. Kompetencat dhe tematikat e lëndës: Aftësim teknologjik praktik

Kompetencat	Tematikat	I	II	III	IV	V
<ul style="list-style-type: none"> • Komunikimi grafik; • Strukturat dhe materialet teknologjike; • Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike; • Teknologjia, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit. 	Tekstilet dhe mirëmbajtja	-	-	-	10	10
	Mirëmbajtja e mjedisit shtëpiak, e kopshtit	-	-	-	10	10
	Gatimi dhe ruajtja e ushqimeve	-	-	-	15	15

4.8 KURRIKULA NË BAZË SHKOLLE

Kurrikula në bazë shkolle është pjesë e kurrikulës së përgjithshme, e cila në dallim nga kurrikula bërthamë zgjidhet nga shkolla dhe zhvillohet brenda kohës së planifikuar në planin mësimor, në përputhje me interesat, potencialet, mundësitë, informacionet paraprake të nxënësve dhe me mundësitë e shkollës.

Kurrikula në bazë shkolle në arsimin fillor mund të përdoret:

- për veprimtari në përmbushje të nevojave dhe të interesave të nxënësve, si dhe në funksion të përmbushjes së kompetencave kyç;
- për zgjerimin dhe thellimin e lëndëve të kurrikulës bërthamë;
- për hartimin e moduleve me bazë temash, nxitjen e të mësuarit me projekte dhe veprimtari të ndryshme nga kurrikula bërthamë dhe çështjet ndërkurrikulare.

Për kurrikulën me zgjedhje në arsimin fillor nxënësi nuk merr vlerësim në regjistër.

5 PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES

Planifikimi është një proces i rëndësishëm i zbatimit të kurrikulës, i cili i krijon mundësinë mësuesit të jetë krijues dhe fleksibël në procesin e mësimitdhënies. Për një planifikim të mirë, mësuesi i arsimit fillor duhet të njohë dokumentet e mëposhtme:

- Kornizën kurrikulare të arsimit parauniversitar;
- Kurrikulën bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor;
- Programet mësimore lëndore që zhvillohen nga klasa e parë deri në klasën e pestë;
- Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënimit në arsimin fillor.

Baza e një planifikimi të suksesshëm është njohja dhe zotërimi i kërkesave të programeve mësimore në nivel klase, shkalle dhe cikli.

5.1 Llojet e planifikimeve

Planifikimi i mësimitdhënies përfshin:

- planifikimin vjetor të lëndës;
- planifikimin e tri periudhave;
- planifikimin ditor.

Në fillim të vitit shkollor, mësuesi dorëzon pranë drejtorisë së shkollës *planifikimin vjetor* të lëndës, i cili shërben si një kornizë e ndarjes së përgjithshme të përmbajtjes lëndore dhe të orëve mësimore, si edhe *planifikimin e periudhës së parë*. Planifikimet e periudhës së dytë dhe të tretë dorëzohen para fillimit të secilës prej tyre.

Gjatë vitit shkollor, sipas rrethanave që i krijohen, në planifikimet e dorëzuara mund të bëhen ndryshime, sepse mësuesi planifikon duke u bazuar në përparimin e nxënësve dhe në vështirësitë e hasura në periudhat paraardhëse.

5.2 Planifikimi vjetor i lëndës

Për realizimin e planifikimit vjetor të lëndës, mësuesi, përveç programit mësimor, duhet të studiojë edhe tekstin shkollor që ka përzgjedhur të punojë. Realizimi i programit është qëllimi i vërtetë i mësuesit, kurse teksti i përzgjedhur shkollor është një prej mjeteve që e ndihmojnë për të përmbushur këtë qëllim. Kur mësuesi evidenton që tekstit të përzgjedhur i mungon një njohuri, koncept a tematikë nga programi ose nuk përmbush një rezultat të nxëni, atëherë mësuesi gjen dhe përdor burime të tjera të nxëni.

Planifikimi vjetor është një plan sintetik. Mësuesi e planifikon shpërndarjen e orëve dhe përmbajtjen kryesore lëndore për tri periudha, me qëllim krijimin e idesë për shtrirjen dhe realizimin e saj (të përmbajtjes) në secilën prej tyre.

Tabela 15. Formati i planifikimit mësimor vjetor

Kompetencat/ Tematikat	Shpërndarja e përmbajtjes lëndore sipas kompetencave/ tematikave		
	Periudha e parë	Periudha e dytë	Periudha e tretë

Në kolonën “*Kompetencat/Tematikat*” shkruhen emërtimet e tematikave/ kompetencave që ka lënda dhe orët e tyre përkatëse.

Në kolonën “*Shpërndarja e përmbajtjes lëndore*” vendoset përmbajtja e lëndës që do të trajtohet në secilën periudhë dhe sasia e orëve në të cilën do të zhvillohen. Gjithashtu, vendoset edhe totali i orëve për secilën periudhë, ku përfshihen njohuri, projekte, përsëritje, diktime, ekskursione mësimore, teste etj., që parashikon të zhvillojë mësuesi në secilën periudhë.

5.3 Planifikimi i tri periudhave

Planifikimi i periudhës është një planifikim më afatshkurtër dhe më i detajuar i mësimdhënies. Ky lloj planifikimi kërkon që mësuesi të përcaktojë me kujdes përmbajtjet mësimore që do të zhvillojë gjatë kësaj periudhe, orët mësimore dhe orët e projekteve brenda të cilave ato do të realizohen, duke planifikuar paraprakisht situatat e të nxënit përmes të cilave do të mundësohet zhvillimi i kompetencave, burimet e të nxënit, metodologjitë e mësimdhënies si dhe llojet e vlerësimit dhe instrumentet vlerësuese.

Plani i një periudhe është analitik dhe në të detajohen temat mësimore që do të zhvillohen përgjatë saj. Mësuesi harton planin e periudhës përkatëse në fillim të saj dhe e dorëzon në drejtorinë e shkollës para fillimit të periudhës. Ky plan hartohet duke iu përmbajtur programit dhe tekstit mësimor përkatës. Në planet sipas periudhave planifikohen të gjitha orët. Mësuesit janë të lirë të bëjnë ndryshimet e tyre hap pas hapi në varësi të specifikave të lëndës së tyre. Nëse gjatë zbatimit të planit ndjen nevojën e ndryshimit, mësuesi i bën duke njoftuar dhe ndryshuar planifikimin e dorëzuar në drejtorinë e shkollës.

Kohëzgjatja e secilës periudhë në numër javësh varet nga përmbajtja lëndore. Tri periudhat variojnë sipas muajve Shtator-Dhjetor, Janar – Mars dhe Prill-Qershor.

Nëse marrim si shembull Periudhën e parë Shtator – Dhjetor, Periudha jo domosdoshmërisht mbyllet kur përfundon mësimi dhe fillojnë pushimet dimërore. Përfundimi i saj varion nga njëra lëndë në tjetrën, në varësi të mbylljes së orëve të një kapitulli, tematike ose grupi temash. Përfundimin e periudhës e përcakton mësuesi, mbi bazën e planifikimit lëndor që ka bërë.

Periudha e dytë, Janar – Mars, fillon në përfundim të Periudhës së parë. E njëjta logjikë ndiqet edhe për Periudhën e tretë. Në përfundim të Periudhës së tretë, Plani mësimor për çdo lëndë duhet realizuar 100%.

Temat mësimore dhe orët e projektit janë të shpërndara gjatë gjithë periudhës. Tema e Detyrës ose e testit përmbledhës nuk vendoset domosdoshmërisht si orë e fundit e periudhës. Ajo mund të vendoset edhe disa orë përpara, atëherë kur mësuesi vlerëson të arsyeshme kryerjen e saj/tij, pasi janë përmbushur rezultatet e të nxënit për kapitullin e fundit.

Formati i planifikimit të një periudhe

Në vijim jepet *formati orientues* i planifikimit të periudhës.

Tabela 16. Formati i planifikimit të periudhës

Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç dhe kompetencave të fushës/ lëndës						
Nr.	Kompetencat/ Tematikat	Temat mësimore	Situatat e të nxënit	Metodologjitë dhe veprimtaritë e nxënësve	Vlerësimi	Burimet/ materialet dhe mjetet didaktike
1.						
...						

Në rubrikën “*Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyç dhe kompetencave të fushës/ lëndës*” vendosen rezultate specifike që realizohen përgjatë temave mësimore në secilën periudhë. Pra mësuesi, duke njohur përmbajtjen e temave dhe të veprimtarive mësimore përcakton rezultatet e kompetencave kyç dhe të fushës/ lëndës që përmbushen në to.

Në kolonën “*Numri*” renditen të gjitha orët mësimore që do të realizohen nga mësuesi gjatë një periudhe.

Në kolonën “*Kompetencat/Tematikat*” vendosen kompetencat ose tematikat për të cilat jepen orët në secilin program lëndor. Kjo kolonë përkon me kolonat e tri periudhave të planifikimit vjetor. P.sh., për lëndën e gjuhës shqipe do të vendosen kompetencat, sepse orët mësimore të programit janë shpërndarë në 5 kompetencat që ka kjo lëndë. Në lëndën e diturisë së natyrës do të vendosen tematikat, sepse orët mësimore të programit janë shpërndarë në 5 tematikat që ka kjo lëndë. E njëjta logjikë ndiqet për të gjitha lëndët.

Në kolonën “*Temat mësimore*” shënohen të gjitha temat mësimore që do të zhvillohen gjatë periudhës. Pra, mësuesi shënon si temat që i korrespondojnë tekstit shkollor, ashtu edhe përsëritjet, diktimet, testet, analizat e rezultateve, konkurset, leximet jashtë klase, projektet, ekskursionet, veprimtaritë praktike, vizitat mësimore, demonstrime e prezantime të ndryshme, shfaqje artistike, teatrale, ekspozita etj.

Në kolonën “*Situatat e të nxënit*” vendosen, nëse është e mundur, situatat e të nxënit që mësuesi parashikon të realizojë gjatë periudhës, të cilat mund të ndryshohen dhe plotësohen përgjatë zhvillimit të lëndës. Situatat e të nxënit mund t’i përkasin një teme mësimore, disa temave

mësimore, ashtu sikurse mund të ketë tema mësimore për të cilat mësuesi nuk mund të zhvillojë situata të nxëni. Për krijimin e situatës së të nxënit mësuesi mund të shfrytëzojë një ditëlindje apo një mjedis ku festohet ajo ose mund të shfrytëzojë mjedis në të cilin punon një dentist etj. Nëse në artin pamor, për të përfituar përvoja artistike, programi kërkon që nxënësi të zbulojë profesione të ndryshme në lidhje me artin pamor si: artistë, artizanë, arkitektë, mësues arti, dizajnë etj., atëherë tema mësimore mund të zhvillohet në studion e një artisti, në punishtet e një artizani, në një studio grafike etj., me të cilët është biseduar paraprakisht. Pra situata e të nxënit është një situatë praktike ose reale në të cilën nxënësi përmbush një ose disa rezultate të nxëni.

Në kolonën “*Metodologjitë dhe veprimtaritë e nxënësve*” shënohen metodat, teknikat dhe format e ndryshme të organizimit të punës me nxënësit që mësuesi parashikon t’i zhvillojë në temat mësimore të periudhës. Plotësime dhe detajime në këtë rubrikë bëhen gjatë zhvillimit të temave mësimore.

Në kolonën “*Vlerësimi*” shënohen teknikat dhe instrumentet e vlerësimit që do të përdoren për vlerësimin e nxënësit përgjatë periudhës. Për plotësimin e kësaj rubrike mësuesi do t’i referohet rubrikës “Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të fushës/lëndës”, të cilat nxënësi do të demonstrojë në mënyra të ndryshme (*sa dhe si i ka përmbushur*). Gjithashtu, në këtë kolonë, mësuesi mund të shënojë edhe teknikat e vlerësimit që parashikon të përdorë.

Kolonën “*Burimet/ materialet dhe mjetet didaktike*” mësuesi e plotëson për tema të caktuara mësimore, ku përveç tekstit shkollor ai parashikon të përdoren burime të tjera, cd, site interneti, materiale dhe mjete didaktike.

5.4 Planifikimi ditor

Në përditshmërinë e tij mësuesi i arsimit fillor bën planifikimin ditor për të gjitha lëndët që do të zhvillojë sipas orarit javor që ka plotësuar në regjistrin e klasës.

Në rubrikën “Lënda” shënohet emërtimi i lëndës.

Në rubrikën “Tema/t mësimore” shënohet tema e mësimimit për një orë të caktuar mësimore. Në rastin kur gjatë një dite, mësuesi ka për të zhvilluar dy orë nga e njëjta lëndë, atëherë shënohet/n tema/t dhe shtjellimi bëhet për të dyja orët së bashku, pra për 90 minuta. Në rastin kur mësuesi zhvillon një ditë të integruar mësimore, atëherë ai shënon që në fillim të gjitha temat mësimore sipas lëndëve.

Rubrika “Situata e të nxënit” plotësohet në rast se mësuesi ka parashikuar për atë temë mësimi një situatë të tillë. Në rast se nuk ka, atëherë kjo rubrikë nuk shënohet fare. Në vijim jepen rubrikat e planit ditor. Drejtuesit e shkollave të kujdesen që planet ditore të jenë në bllok/fletore dhe jo në fletë të veçanta, duke demonstruar përgatitjen serioze për mësim dhe në vijimësi.

Tabela 17. Planifikimi ditor

Data ___/___/_____
Lënda:
Tema/t mësimore
Situata e të nxënit
Rezultatet e të nxënit Në përfundim të temës së mësimi, nxënësi: <ul style="list-style-type: none">▪▪ ...
Konceptet lëndore/ Termat kryesorë <ul style="list-style-type: none">▪...
Burimet, materialet dhe mjetet didaktike

<ul style="list-style-type: none"> ▪ ...
Lidhja ndërlëndore ose me temat ndërkurrikulare (opsionale)
Ecuria e zhvillimit të mësimit (Metodologjia dhe veprimtaritë e nxënësve)
Vlerësimi i nxënësve
Detyra e shtëpisë/Përgatitja e nxënësit në shtëpi

Rubrika “*Rezultatet e të nxënit*” që mësuesi shënon për një temë të caktuar mësimore, rrjedh nga rubrika “*Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave të lëndës*”, të përcaktuara në planifikimin sipas periudhave. Ato duhet të jenë specifike, të matshme, të arritshme dhe të kuptueshme për atë që pritet të demonstrohet nga nxënësi.

Në rastin kur mësuesi zhvillon një ditë të integruar mësimore, atëherë ai shënon në grup të gjitha rezultatet e të nxënit për të cilat do të punohet gjatë gjithë ditës.

Për hartimin e rezultateve të të nxënit, mësuesi i referohet foljeve përshkruese të Taksonomisë së Blumit, të cilat në mënyrë të përmbledhur i gjen në tabelën e mëposhtme.

Tabela 18. Taksonomia e Blumit

Nivelet e të menduarit	Foljet përshkruese për rezultatet e të nxënit
<p>Rikujtimi/riprodhimi</p> <p>Është rikujtimi ose riprodhimi i një diçkaje pa shpjegime dhe pa e lidhur me gjë tjetër. Përsëritje e emrave, e rregullave, e përkufizimeve dhe e shpjegimeve ashtu siç është dhënë. Është niveli më i ulët i rezultateve të nxënësve në fushën e njohjes.</p>	<p><i>Përkufizon, përsërit, përshkruan me fjalët e tekstit, identifikon, vë në tabelë, citon, liston, emërton, riprodhon, nënvizon, tregon, vendos, lidh etj.</i></p>

<p>Të kuptuarit</p> <p>Është aftësia për të kapur kuptimin e materialit dhe për të nxjerrë në dukje gjërat më kryesore.</p>	<p><i>Shpjegon, zgjeron, jep shembuj, perifrazon, rishkruan, shoqëron, interpreton ndryshe, krahason, ilustron, lidh, parashikon, përmbledh, rregullon, mbron, diferencon, diskuton, llogarit, dallon, paraqet etj.</i></p>
<p>Zbatimi:</p> <p>Është aftësia për të përdorur informacionin e mësuar në situata të reja dhe konkrete. Zbatohen rregulla, metoda, koncepte, parime, ligje dhe teori.</p>	<p><i>Zbaton, përlllogarit, shfrytëzon, ndryshon, njehson, klasifikon, provon, vë në dukje, manipulon, përgatit, lidh, plotëson, tregon, ekzaminon, zgjidh, shpjegon, përdor, ndryshon etj.</i></p>
<p>Analiza:</p> <p>Është aftësia për ta copëtuar materialin në pjesë përbërëse dhe për të përcaktuar se si lidhen pjesët me njëra-tjetrën.</p>	<p><i>Copëton, analizon, ndan në pjesë, shpjegon përse, diferencon, klasifikon, shquan, dallon, vë në dukje, lidh, seleksionon, rregullon, krahason, integron etj.</i></p>
<p>Vlerësimi</p> <p>Është aftësia për të bërë gjykime bazuar në kritere dhe standarde.</p>	<p><i>Vlerëson, çmon, nxjerr një përfundim, merr në konsideratë, kritikon, gjykon, shpjegon, justifikon, interpreton, lidh, përmbledh, mat, vendos, rekomandon, krijon, realizon sipas një ideje origjinale, përzgjedh etj.</i></p>
<p>Krijimi:</p> <p>Është aftësia për të gjykuar vlerën e një materiali, të mirën e një ideje, motivet e sjelljeve, vlerësimin e zgjidhjeve të problemit, ndërtimin e komunikimeve gjykuese, si dhe</p>	<p><i>Kombinon, harton, krijon, zgjidh (një problem që ka shumë rrugë), kompozon, jep mendime, përmirëson, shkruan, planifikon, tregon, riorganizon, prodhon, harton, transmeton, krijon, propozon,</i></p>

krijimin mbështetur në vlerësim, si dhe në idetë/mendimet origjinale etj.	<i>planifikon, prodhon, modifikon, specifikon, kombinon, organizon, sintetizon, klasifikon, përfundon, zhvillon, modifikon, ndërton etj.</i>
---	--

Në rubrikën “*Konceptet/ fjalët kyç*” do të shënohen konceptet apo termat kryesore që do të trajtohen gjatë temës së mësimit.

Në rastin kur mësuesi zhvillon një ditë të integruar mësimore, atëherë ai i shënon në grup të gjitha konceptet kryesore që do të trajtohen gjatë ditës.

Në rubrikën “*Burimet, materialet dhe mjetet didaktike*” mësuesi shënon burime dhe materiale specifike që duhen për atë orë mësimi dhe që janë të rëndësishme e të vlefshme për t’u shfrytëzuar.

Rubrika “*Lidhja ndërlëndore ose me temat ndërkurrikulare*” është një rubrikë shumë e rëndësishme e planifikimit ditor. Për mësuesin e ciklit fillor, i cili e jep vetë pjesën më të madhe të lëndëve të një klase, kjo rubrikë do të jetë e shkrirë si te rubrika “Tema/t mësimore”, edhe te “Ecuria e zhvillimit të mësimit”. Në rast se një temë e caktuar mësimi nuk ka lidhje me fushat e tjera apo me temat ndërkurrikulare, atëherë ajo rubrikë nuk shënohet fare.

Në rubrikën “*Ecuria e zhvillimit të mësimit*”, mësuesi shënon hap pas hapi të gjitha veprimtaritë që do të kryejë:

- brenda një ore mësimi;
- brenda dy orëve mësimi të një pas njëshme nga e njëjta lëndë;
- brenda një dite të integruar.

Gjithashtu në këtë rubrikë, mësuesi shënon veprimtaritë dhe metodat që do të përdoren prej tij dhe nga nxënësit.

Në rubrikën “*Vlerësimi*” mësuesi shënon për çfarëdo t’i vlerësojë nxënësit apo do të mbajë shënime vlerësuese. Vlerësimi bazohet në nivelet e arritjeve të përshtatura për konceptet e zhvilluara në tema të ndryshme mësimore. Në kurrikulën me kompetenca, mësuesi përpiket që gjatë gjithë kohës t’i vendosë të gjithë nxënësit në veprimtari praktike dhe në situata të tilla që ata të veprojnë, me qëllim përmbushjen e rezultateve të të nxënit. Gjatë kohës që nxënësit punojnë, mësuesi ndjek performancën e secilit prej tyre dhe mban shënime vlerësuese për ta. Pra, mësuesi plotëson:

Nxënësi vlerësohet për: (shkruhen pritshmëritë për përmbushjen e rezultateve të të nxënit)

- ...
- ...

Vlerësimi është i lidhur me përmbushjen e rezultateve të të nxënit për konceptet e zhvilluara në temat mësimore. Për vlerësimin e nxënësit mund të përdoren ushtrimet nga teksti i nxënësit ose ushtrime të përgatitura nga mësuesi. Mësuesi vendos se në cilin rast vlerësimi i nxënësit do të hidhet në regjistër. Vlerësimet e tjera që bën gjatë periudhës, mësuesi i mban në fletoren personale të shënimeve. Nëse vlerësimi mbështetet në një detyrë me shkrim të nxënësit, sugjerohet që kjo detyrë të ruhet në fletoren ose në dosjen e nxënësit.

Në rubrikën “Detyra e shtëpisë/Përgatitja e nxënësit në shtëpi” shënohen ushtrimet, kërkesat, temat, titujt e detyrave që do t’u jepen nxënësve për të punuar ose për t’u përgatitur në shtëpi. Detyrat mund të jenë individuale ose në grup.

5.5 Planifikimi i kurrikulës në bazë shkolle

Planifikimi i kurrikulës në bazë shkolle bëhet sipas tri periudhave të vitit, njësoj si planifikimi për çdo lëndë të arsimit fillor. Rubrikat e planifikimit të kurrikulës në bazë shkolle janë:

Tabela 19. Planifikimi i kurrikulës në bazë shkolle

Rezultatet e të nxënit			
...			
Nr.	Temat/ Veprimtaritë	Kohëzgjatja/ Nr. i orëve	Materialet mësimore, burimet dhe mjetet ndihmëse
1.			
2.			
...			

Tabela 20. Planifikimi ditor i kurrikulës në bazë shkolle

Data ___/___/_____
Tema/ Veprimtaria
Rezultatet e të nxënit
Burimet, materialet dhe mjetet didaktike
Udhëzimet metodike për realizimin e saj
Veprimtaria 1
Veprimtaria 2
...
Detyra shtëpie (nëse ka)

6 VLERËSIMI I NXËNËSIT NË ARSIMIN FILLOR

Vlerësimi i nxënësve është ndër komponentët më të rëndësishëm të kurrikulës me bazë kompetencat. Ky vlerësim, bazuar në rezultatet e të nxënësve, përfshin gjykimin për arritjet e nxënësve (njohuri, shkathtësi, vlera dhe qëndrime) përkundrejt niveleve të arritjeve.

Gjatë viteve të para të shkollës, kujdes i veçantë i kushtohet zhvillimit të personalitetit të fëmijës dhe qëndrimit pozitiv ndaj të nxënësve, si bazë për zhvillimin e kompetencës kyç “Të mësuarit për të nxënë”.

Mësuesi, në përputhje me parimet themelore të vlerësimit, siguron përdorimin e të gjitha llojeve të vlerësimit, të cilat përcaktohen si të domosdoshme për të vlerësuar arritjet dhe zhvillimin individual, për të evidentuar anët dhe pikat e forta, si dhe drejtimit të të cilat çdo nxënës ka nevojë për ndihmë, mbështetje dhe motivim.

Vlerësimi realizohet nëpërmjet përdorimit të instrumenteve dhe të procedurave të ndryshme të mbledhjes së të dhënave, interpretimit dhe analizës së tyre në dobi të përmirësimit të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Njohja më e mirë e nxënësve dhe e arritjeve të tyre e ndihmon mësuesin dhe prindin të punojnë më tepër në ato drejtime, të cilat pengojnë ecurinë dhe përparimin e tyre të mëtejshëm. Kohë pas kohe, gjykimin për atë çfarë arrin nxënësi, sinjalizon të rriturin si po lëviz trajektorja e progresit të tyre.

Vlerësimi formues (ndryshe quhet edhe vlerësimi për të mësuar) është një proces i mbledhjes dhe i interpretimit të informacionit për shtrirjen dhe suksesin e të mësuarit të një individi, të cilin nxënësi dhe/ose mësuesi i tyre mund ta përdorin për të vendosur rezultate të reja të nxënësve dhe për të planifikuar veprimtaritë e mëtejshme mësimore.

Qëllimet e vlerësimit formues bazohen në idenë se nxënësit mund të përfitojnë nga rezultatet nëse ato i japin atij si informacion vlerësimi. Kjo kërkon rritjen e vetëdijes së nxënësve për të mësuarit, për kompetencat që duhet të arrihen dhe mundësitë të të mësuarit. Kriteret duhet të specifikohen në një formë që është e dobishme për planifikimin e mëtejshëm, d.m.th. të jenë mjaft të veçanta për të identifikuar pikat e dobëta që duhet të korrigjohen dhe pikat e forta që duhet të zhvillohen.

Vlerësimi përmbledhës

Vlerësimi përmbledhës ka si qëllim **të përmbledhë arritjet ose zotësinë e nxënësit në një kohë të caktuar**. Vlerësimi përmbledhës shpesh përdoret në fund të realizimit të një programi, megjithëse ai mund të përdoret edhe gjatë një programi *për t'i dhënë mundësi nxënësit dhe/ose mësuesit të përmbledhin rezultatet ose zotësitë e arritura në atë pikë të programit*. Vlerësimi përmbledhës mund t'i referohet një kriteri, një norme ose një grupi.

Megjithëse termat "**formues**" dhe "**përmbledhës**" shpesh përdoren sikur përshkruajnë lloje të ndryshme të vlerësimeve, **rezultati i një vlerësimi të vetëm mund të përdoret për më shumë se një qëllim**. Për këtë arsye, këto dy terma nuk janë përshkrime të llojeve të ndryshme të vlerësimeve, *por të përdorimeve të ndryshme të informacioneve që rrjedhin nga një vlerësim*.

I njëjti informacion, i mbledhur duke përdorur të njëjtën metodë vlerësimi, quhet "formues" nëse përdoret për të ndihmuar të mësuarit dhe mësuesin. Ai quhet "përmbledhës" nëse përdoret për të përmbledhur dhe për të raportuar të mësuarit.

6.1 Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III

Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III bëhet me përshkrim. Përshkrimi i vlerësimit ka si qëllim evidentimin e anëve të forta, të dobësive dhe vështirësitë konkrete që ka nxënësi në çdo program lëndor. Mbajtja e shënimeve për ecurinë dhe përparimin e nxënësve siguron informacione të dobishme për mësuesin dhe e ndihmon në rishikimin e përmbajtjes mësimore në ato raste kur të nxënët nuk është në rezultatet e pritshme.

Vlerësimi i nxënësit për arritjen e kompetencave të fushave të të nxënët realizohet në përfundim të secilës periudhë. Ai bazohet në shënimet vlerësuese të mësuesit që lidhen me vlerësimin e vazhduar, në vlerësimin e punimeve dhe të produkteve individuale të nxënësit që tregojnë interesin për të nxënë, në realizimin e projekteve, si dhe në vlerësimin e testeve ose të detyrave përmbledhëse.

Në fund të çdo periudhe për të bërë vlerësimin përshkrues të nxënësit, mësuesi mban parasysh raportet mes tri llojeve të vlerësimit:

- ***Përgatitja dhe performanca sistematike e nxënësit*** (Vlerësimi i vazhduar) përbën 45% të vlerësimit. Ky vlerësim ndahet 15% për përgatitjen e nxënësit dhe detyrat që ai bën në shtëpi; 30% për punët e detyrat me shkrim që kryen nxënësi në klasë dhe përgjigjet që jep me gojë.
- ***Punimet krijuese dhe nisimat individuale, produktet dhe detyrat specifike që nxënësi bën në grup, projektet*** dhe veprimtari të tjera që zhvillohen në klasë përbën 25% të vlerësimit.
- ***Diktimet, testimet dhe detyrat përmbledhëse*** përbëjnë 30% të vlerësimit. Ato dëshmojnë qëndrueshmërinë e rezultateve të të nxënët të nxënësit.

Pra, për të bërë vlerësimin e nxënësit në fund të çdo periudhe, mësuesi do të mbajë parasysh sa përgatitjen sistematike të nxënësit, aq edhe qëndrueshmërinë e njohurive dhe të aftësive të fituara gjatë punës për projektet. Sigurisht që për nxënësin do të merret në konsideratë përgatitja që bën në shtëpi dhe interesin që shfaq për të nxënë.

Në klasat I-III të arsimit fillor, vlerësimi i nxënësit në regjistër bëhet për secilën kompetencë që ka çdonjëra nga fushat e të nxënët/ lëndët. Pra, si për vlerësimin në fund të çdo periudhe,

ashtu edhe për vlerësimin përfundimtar në fund të vitit shkollor, nxënësi do të marrë vlerësime për secilën kompetencë.

Kjo do të thotë që:

- për lëndën e gjuhës shqipe nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme; Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar; Të lexuarit e teksteve të ndryshme; Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale; Përdorimi i drejtë i gjuhës.*
- për lëndën e matematikës nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Zgjidhja e situatave të thjeshta problemore; Arsyetimi dhe vërtetimi matematik; Të menduarit dhe komunikimi matematik; Lidhja konceptuale dhe Modelimi matematik.*
- për lëndën e diturisë së natyrës nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre; Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore; Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës.*
- për lëndën e edukimit për shoqërinë/ qytetarinë nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencën *shoqërore dhe qytetare.*
- për lëndën e historisë nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Kërkimi historik; Përdorimi i burimeve; Analiza shkak-pasojë; Interpretimi historik; Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën.*
- për lëndën e muzikës nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Krijimi muzikor; Performimi/ interpretimi muzikor; Vlerësimi i veprave muzikore.*
- për lëndën e artit pamor nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Krijimi artistik; Performimi artistik; Vlerësimi artistik.*
- për lëndën e kërcimit nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Krijimi nëpërmjet lëvizjeve; Performimi/ interpretimi i lëvizjeve dhe i kërcimit; Vlerësimi i lëvizjeve dhe i kërcimeve.*
- për lëndën e edukimit fizik, sportet dhe shëndeti nxënësi do të marrë vlerësim për kompetencat: *Zhvillimi i aftësive lëvizore në përshtatje me situata lëvizore e sportive të ndryshme; Ndërveprimi me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive; Përshtatshmëria me një stil jete aktiv e të shëndetshëm.*

Vlerësimi vjetor lëndor i nxënësit bëhet duke pasur parasysh vlerësimin përmbledhës (përfundimtar) të nxënësit sipas kompetencave të fushës/ lëndës.

Vlerësimi i nxënësit në klasat I-III realizohet me *5 nivelet e arritjes së kompetencave* si më poshtë:

- *Niveli 1. “Arritje të pakënaqshme”*, kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënësit. Nxënësi që paraqet arritje të pakënaqshme plotëson pak detyra; ka nevojë të kujtohet shpesh për të bërë detyrat dhe është rrallë herë i motivuar; detyrat i mungojnë, janë të paplotësuara, të pasakta dhe mund t’i dorëzojë me vonesë; rrallë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutimet në klasë dhe bashkëpunon me nxënësit e tjerë.
- *Niveli 2. “Arritje që kanë nevojë për përmirësim”*, kur nxënësi ka arritur vetëm pak nga kërkesat bazë të të nxënësit dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij dhe e mësuesit. Nxënësi që paraqet arritje që kanë nevojë për përmirësim është i motivuar për të plotësuar detyrat, megjithatë disa prej tyre mund të mos i zhvillojë plotësisht; herë pas here duhet kujtuar që të bëjë detyrat; ndonjëherë dëgjon me vëmendje dhe merr pjesë në aktivitete dhe diskutime në klasë dhe punon bashkërisht në grupe.
- *Niveli 3. “Arritje të kënaqshme”*, kur nxënësi ka përmbushur kërkesat bazë të të nxënësit dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, arrin të përparojë. Nxënësi që paraqet arritje të kënaqshme zakonisht është i motivuar dhe i përqendruar në detyra; i plotëson detyrat në kohë; zakonisht dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe bashkëpunon në grup.
- *Niveli 4. “Arritje shumë të kënaqshme”*, kur nxënësi ka përmbushur pjesën më të madhe të kërkesave të të nxënësit. Nxënësi që paraqet arritje shumë të kënaqshme është i vetë-motivuar; i plotëson detyrat me kënaqësi; shpesh kërkon dhe vihet përpara sfidave; thuajse gjithmonë dëgjon me vëmendje, merr pjesë në diskutim dhe në aktivitetet e klasës dhe punon bashkërisht në grupe.
- *Niveli 5. “Arritje të shkëlqyera”*, kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e të nxënësit të programit lëndor. Nxënësi që paraqet arritje të shkëlqyera është i vëmendshëm; është i vetëdrejtuar; kërkon sfida; plotëson detyrat me entuziazëm; ndërmerri iniciativa; merr pjesë me entuziazëm në diskutim dhe në aktivitetet e klasës; kontribuon në ndërveprimin efektiv të grupeve bashkëvepruese; merr përgjegjësi për të zgjeruar rritjen personale dhe akademike.

6.2 Vlerësimi i nxënësit në klasat IV dhe V

Dokumenti “Nivelet e arritjes së kompetencave të fushave të të nxënët” për shkallën 1 dhe 2 të kurrikulës, shpreh kritere të njësuara për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse në nivel kombëtar **referuar ndaj një kriteri të përcaktuar**. Nivelet përcaktojnë arritjen e kompetencës nga nxënësi në fund të çdo viti shkollor, sipas shkallëve përkatëse.

Ky sistem vlerësimi zbatohet për arsimin bazë dhe të mesëm. Në këtë sistem, zbatohet vlerësimi me notë: nga nota 4 (pakaluese) në notën 10 si nota më e lartë. Nga klasa e katërt deri në klasën e dymbëdhjetë, janë përcaktuar **katër nivele arritjeje**² të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që demonstroi nxënësi:

- Niveli I (*pamjaftueshëm, nota 4*), kur nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënët.
- Niveli II (*mjaftueshëm, notat 5-6*), kur nxënësi ka arritur disa nga kërkesat bazë të të nxënët dhe kërkohet mbështetje dhe punë e vazhdueshme nga ana e tij për të përparuar.
- Niveli III (*mirë, notat 7-8*), kur nxënësi ka përmbushur një pjesë të konsiderueshme të kërkesave bazë të të nxënët dhe, kur me mbështetjen e mësuesit, vazhdon të përparojë.
- Niveli IV (*shumë mirë, notat 9-10*), kur nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi kërkesat e të nxënët të programit lëndor.
- Për këtë arsye, vlerësimi në klasat IV dhe V do të shërbejë si pikë lidhje ndërmjet vlerësimit përshkrues në klasat I-III dhe vlerësimit me notë në klasat e tjera të sistemit arsimor parauniversitar.

²Në klasat IV-V janë përcaktuar **katër nivele arritjeje**, pasi në këtë grup-moshë fillon të rritet pesha e njohurive dhe e formimit akademik në vlerësimin e nxënësit dhe vlerësimi nuk bazohet më në **kriterin e normës**.

6.3 Vlerësimi periodik i nxënësit

Qëllimi i vlerësimit: Qëllimi kryesor i vlerësimit është *përmirësimi i përmbushjes së rezultateve të të nxënësve* nga nxënësi dhe i vetë procesit të të nxënësve. Vlerësimi është procesi gjatë të cilit *mbledhjen të dhënave dhe gjykohet për vlerën* e arritjes së rezultateve të të nxënësve bazuar në nivelet e arritjes.

Vlerësimi është një pjesë e rëndësishme e procesit të mësimdhënies dhe nxënies. Vlerësimi përdoret:

- për të gjykuar mbi përpjekjet e nxënësve;
- për të matur arritjet e nxënësve;
- për të gjykuar dhe përmirësuar procesin e mësimdhënies -nxënies;
- për të raportuar arritjet;
- për t'i dhënë sugjerime nxënësve për përparimin e tyre.

Vlerësimi në arsimin fillor mat arritjet e nxënësve për rezultatet e të nxënësve të përshkruara në programet mësimore për çdo lëndë. Është një proces i vazhdueshëm i identifikimit, mbledhjes dhe interpretimit të informacionit në lidhje me arritjet e nxënësve dhe mund të integrohet në të nxënësve normal të nxënësve.

Vlerësimi i nxënësve në klasat IV-V kryhet nëpërmjet:

- a) Vlerësimit të vazhduar;
- b) Vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse;
- c) Vlerësimit me projekt kurrikular.

6.3.1 Vlerësimi i vazhduar (për të nxënë)

- Në klasat IV dhe V, vlerësimi i vazhduar zë peshën 45% të notës përfundimtare të nxënësit.
- Vlerësimi i vazhduar për të nxënë është pjesë e mësimdhënies dhe motivon përparimin e nxënësit në të gjitha aspektet e të nxënës, në situata të ndryshme të njohura dhe të panjohura.
- Vlerësimi i vazhduar bazohet në vëzhgimet dhe në gjykimet e mësuesit mbi përgjigjet me gojë ose me shkrim, punët në grup, diskutimet, vetëvlerësimin e nxënësit, vlerësimin e nxënësit nga nxënësi, pjesëmarrjen në aktivitete dhe në debatet në klasë, vlerësimin e detyrave të shtëpisë apo të klasës etj.
- Mësuesi vlerëson nxënësin **me notë në regjistër**, vetëm pasi është siguruar që ky vlerësim është objektiv dhe shpreh shkallën e qëndrueshmërisë së performancës së nxënësit për një periudhë të caktuar kohe. Për këtë qëllim, mësuesi mund të *përdorë fletoren e tij personale të regjistrimit të përgjigjeve të nxënësit*, për të argumentuar në çdo kohë, objektivitetin e vlerësimit të tij me notë në regjistër.
- Fletorja personale e mësuesit *nuk është objekt monitorimi*.
- Mësuesi shënon në regjistër të paktën 2 (dy) vlerësime me notë për çdo periudhë për lëndët që zhvillohen me 1-2 orë në javë dhe 3 (tri) vlerësime me notë për lëndët që zhvillohen me 3 ose më shumë orë në javë.
- Mësuesi nxjerr notën e vlerësimit të vazhduar për çdo periudhë duke u bazuar në notat e nxënësit në regjistër, punët e mbledhura në dosje (punë/detyra/krijime që i vlerëson të rëndësishme, si pjesë e përparimit dhe e arritjeve të nxënësit) dhe në shënimet e mbajtura. Mësuesi merr në konsideratë **balancën** ndërmjet njohurive, shkathtësive, qëndrimeve, ashtu siç përshkruhet në rezultatet e të nxënës në programin lëndor përkatës.
- Mësuesi ka përgjegjësi për të informuar prindërit dhe nxënësin për ecurinë dhe mundësinë e nxënësit për progres në vazhdimësi.

6.3.2 Vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse

- Vlerësimi i të nxënit quhet shpesh vlerësim përmbledhës. Përdoret për të mbledhur prova dhe të dhëna që tregojnë nëse mësimdhënia ka realizuar qëllimin e saj. Zakonisht planifikohet në fund të një tematike apo të një periudhe të caktuar. Ky është një vlerësim *formal* dhe kryhet edhe për efekt raportimi. Në përfundim të periudhës (kur e vendos mësuesi) kryhet *vlerësimi me test përmbledhës*, i cili ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Në klasat IV dhe V, vlerësimi me test ose detyrë përmbledhëse zë peshën 30% të notës përfundimtare të nxënësit.
- Si dhe kur realizohet testi përmbledhës?
- Në pjesën e fundit të periudhës kryhet *vlerësimi me test përmbledhës*, që ka për qëllim të matë nivelin e arritjeve të nxënësit për një grup të caktuar rezultatesh të nxëni për periudhën përkatëse.
- Në lëndë të tilla, si: Edukim fizik, sporte dhe shëndet; Art pamor; Muzikë; Kërcim; Teatër; TIK; Aftësim teknologjik, vlerësimi bëhet vetëm me **detyrë përmbledhëse**. Mësuesi përcakton detyrën përmbledhëse në përputhje me veçoritë e lëndës dhe duke marrë parasysh nivelet e arritjes për lëndën përkatëse. Detyra përmbledhësi, nga vetë emërtimi, ka të njëjtën vlerë/peshë në notë si testi përmbledhës. Testi vlerëson përmbushjen e koncepteve kryesore, më të rëndësishme të trajtuara, përgjatë periudhës. Të njëjtin qëllim ka edhe Detyra përmbledhëse. Nxënësi do të përgatitet dhe do të prezantojë mbështetur në grupin e koncepteve të trajtuara gjatë periudhës.
- Për çdo detyrë përmbledhëse mësuesi përcakton temën, strukturën/formatin/rubrikat që do të mbahen parasysh nga nxënësi, konceptet kryesore, burimet ose materialet mbështetëse, si dhe kriteret e vlerësimit për çdo notë, nga nota 5-10. Gjithashtu, mësuesi u jep nxënësve vazhdimisht udhëzime që detyra përmbledhëse të realizohet siç duhet dhe nxënësi të performojë sa më mirë. Në lëndët e tjera, mësuesi ka liri për përcaktimin e metodës së realizimit me test ose me detyrë përmbledhëse, duke mbajtur parasysh specifikat e lëndës.

- Testi përmbledhës planifikohet nga mësuesi, kur përmbillet një grup rezultatesh të të nxëniet dhe mësuesi është ***i lirë*** dhe ka fleksibilitet ta vendosë vetë se kur do ta zhvillojë (jo domosdoshmërisht bëhet në fund të periudhës).
- Testi përmbledhës kryhet brenda **45 minutave**.
- Drejtorja e shkollës menaxhon organizimin e testeve përmbledhëse sipas një grafiku, në mënyrë **që të mos ngarkohet nxënësi në fund të periudhës**.
- Testi përmbledhës ***jo domosdoshmërisht*** bëhet në fund të periudhës. Mësuesi e përcakton kohën në varësi të përfundimit të trajtimit të koncepteve kryesore të Periudhës.
- Testet përmbledhëse ruhen *deri në përfundim të vitit shkollor*.
- Vlerësimi i testit/detyrës përmbledhëse pasqyrohet në regjistër, **në kolonën përkatëse**.

6.3.3 Vlerësimi me projekt kurrikular

Projekti kurrikular është pjesë e vlerësimit të nxënësit.

- Në klasat IV dhe V, vlerësimi me projekt kurrikular zë peshën 25% të notës përfundimtare të nxënësit.
- Mësuesi planifikon dhe organizon një projekt të shtrirë gjatë një periudhe ose përgjatë gjithë vitit shkollor.
- Projekti kurrikular në arsimin fillor duhet të jetë ndërlëndor, mund t'i përkasë një fushe të nxëni ose të shtrihet në më shumë se një fushë të nxëni. Nuk përjashtohet projekti lëndor, në rastet kur mësuesi nuk arrin të planifikojë një projekt ndërlëndor, ose kur lënda nuk jepet nga mësuesi i arsimit fillor (siç është Gjuha e huaj, TIK-u dhe 1 orë e Edukimit fizik, që jepet nga mësuesi specialist). Numri i orëve për projekt kurrikular varion nga lënda në lëndë sipas numrit të orëve që kanë në planin mësimor. Për llogaritjen e orëve vjetore të projekteve për çdo lëndë, mësuesi duhet të marrë në konsideratë peshën (25%) që zë projekti në vlerësimin përfundimtar të nxënësit. Gjithashtu, për projektet mund të shfrytëzohen edhe orët e kurrikulës në bazë shkolle.
- Drejtoria e shkollës menaxhon kohën e prezantimit dhe të vlerësimit të projektit kurrikular që të shmanget mbingarkesa e nxënësve në fund të vitit shkollor.
- Nota e projektit kurrikular shënohet në regjistër në kolonën përkatëse.
- Projektet e nxënësve ruhen deri në fund të vitit shkollor.

Projekti si veprimtari integruese me karakter kërkimor e krijues, nxit zhvillimin e aftësive të larta të të menduarit, aftësive komunikuese, të bashkëpunimit, të përdorimit të TIK-ut etj. Projekti nxit të nxënit dhe mësimdhënies me në qendër nxënësin përmes së cilës nxënësit në mënyrë të pavarur ose/dhe si një anëtar i një grupi hulumtojnë mbi një çështje të caktuar ose një problem të lidhur me jetën reale.

Mësuesi, që kur planifikon projektin, duhet të ketë në mendje vlerësimin e tij. Vlerësimi nuk është diçka që ndodh vetëm në fund të projektit, mësuesi vlerëson nxënësit dhe përgjatë zhvillimit të tij.

Planifikimi dhe zbatimi në mënyrë efikase i një projekti kërkon që **mësuesi të përcaktojë qartë detyrën mësimore në detaje** për çdo grup dhe nxënës, është mjaft e rëndësishme që secili nxënës të jetë i përfshirë dhe i angazhuar me detyra të përcaktuara. Mësuesi:

- përcakton rezultatet e të nxënësve që do të arrihen nëpërmjet projektit;
- paraqet fazat e realizimit të projektit dhe jep detaje për secilën prej tyre;
- udhëzon nxënësit për produktin përfundimtar të projektit;
- prezanton te nxënësit kriteret e vlerësimit të projektit;
- vëzhgon dhe jep gjykimin e tij në mënyrë të vazhdueshme për ecurinë e zbatimit të projektit.

Për realizimin e projektit shfrytëzohen përvojat vetjake të nxënësve, njohuritë e fituara dhe njohuritë e marra nga burime të ndryshme. Realizimi i një projekti kërkon përdorimin e më shumë se një metode dhe teknike, si: vrojtimi, studimi i rastit, intervista, puna në grup, puna individuale, përpunim informacioni statistikor etj.

Hapat që ndiqen për realizimin e një projekti:

- Përcaktohet **çështja, tema ose problemi** për të cilin do të hulumtohet.
- Përcaktohen **detyrat** që duhet të realizohen për të grumbulluar të dhënat e nevojshme nga puna e secilit nxënës.
- Grumbullohet materiali dhe/ose **mjetet** e nevojshme.
- Përpunohen dhe **analizohen** të dhënat e grumbulluara.
- Nxirren përfundime dhe **përgjithësime** nga të dhënat e grumbulluara dhe përgatitet produkti përfundimtar.
- Prezantohen **gjetjet** dhe përfundimet e projektit ose **prezantohet** produkti i krijuar.

6.3.4 Planifikimi i projektit

Për planifikimin e një projekti mësuesi ndërton planin e projektit, rubrikat kryesore të të cilit paraqiten më poshtë. Në varësi të tematikës së projektit dhe specifikave të tij, mësuesi mund të pasurojë planin me rubrika të tjera. Mësuesi planifikon në planin e tij ditor çdo orë të planifikuar të projektit sikurse vepron me orët e tjera mësimore.

Rubrikat kryesore të planit të një projekti kurrikular janë:

- *Tema e projektit*, e cila përcaktohet nga mësuesi në bashkëpunim me nxënësit pas prezantimit të disa çështjeve ose problemeve të rëndësishme.
- *Kohëzgjatja e projektit* – përcaktohet numri i orëve mësimore të projekti dhe muajt në të cilët do të realizohet ai. Nëse projekti është ndërlëndor, përcaktohen orët mësimore për secilën lëndë.
- *Rezultatet e të nxënësve*, të cilat kanë lidhje me njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet që do të arrihen nëpërmjet veprimtarive të projektit.
- *Konceptet kryesore që do të mbahen parasysh gjatë zhvillimit të projektit*.
- *Partnerët, nëse ka*. Partnerët kanë si qëllim të ndihmojnë nxënësit sipas nevojave dhe kërkesave që duhet të realizojnë në kuadrin e projektit.
- *Veprimtaritë kryesore*, të cilat do të realizohen gjatë projektit.
- *Burimet kryesore të informacionit*, të cilave duhet t'u referohen nxënësit gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave.
- *Temat e orëve mësimore*, të planifikuara në planin mësimor, sipas lëndëve dhe periudhave.
- *Përshkrimi i produktit të projektit*, i cili pritet të realizohet në fund dhe mënyra e prezantimit të tij.
- *Vlerësimi i nxënësve me notë dhe reflektimi sipas kriterëve që përcakton mësuesi*, të cilat u komunikohen nxënësve që në fillim të projektit. Nxënësit vlerësohen për cilësinë e produktit, si dhe të mënyrave dhe rrugëve që ka ndjekur për realizimin e tij.
- *Përfshirja e nxënësve në vlerësimin e projektit* nxit motivimin dhe përmirëson të nxënësve drejtuar prej tyre. Vetëvlerësimi dhe vlerësimi i nxënësve nga njëri-tjetri

nxit nxënësit të reflektojnë mbi pikat e tyre të dobëta dhe të forta, në mënyrë që të përmirësojnë përpjekjet e tyre të mëtejshme.

6.3.5 Vlerësimi i projektit

Për secilën fazë të projektit, mësuesi përcakton disa kritere të cilat u përgjigjen 4 niveleve të arritjes. Përgatitjen e nxënësit, punët dhe detyrat e kryera, materialet e grumbulluara, si dhe materialet që lidhen me veprimtarinë, fazat dhe produktin final ruhen në dosje përgjatë gjithë vitit.

Në tabelën e mëposhtme janë dhënë tregues që duhen mbajtur parasysh nga mësuesi në vlerësimin përfundimtar të nxënësit për projektin e realizuar. Këta tregues kanë lidhje me cilësinë e realizimit të projektit, e cila konvertohet me notën që i vihet nxënësit në regjistër. Mësuesi është i lirë t'i përshtatë këta tregues në varësi të temës së projektit, të lëndëve të përfshira dhe rezultateve të të nxënës.

Niveli	Cilësia e realizimit të projektit	Vlerësimi me notë	Tregues të vlerësimit të punës së nxënësit
4	Shumë mirë	9-10	<ul style="list-style-type: none"> Nxënësi përmbush plotësisht dhe me cilësi rezultatet e të nxënës. Nxënësi është i përkushtuar dhe punon me seriozitet për realizimin e projektit. Nxënësi është i përgatitur në çdo fazë të projektit dhe ka kryer çdo veprimtari të planifikuar. Nxënësi prezanton produktin e realizuar me siguri në vetvete, mbështetur në punën e kryer. Nxënësi informon, shpjegon, diskuton, ilustron me shembuj ose tregon në varësi të natyrës së produktit të realizuar brenda kohës së përcaktuar.

			<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi ka të dokumentuar punën që ka bërë në kuadrin e realizimit të këtij projekti. • Nxënësi ka realizuar një produkt cilësor, estetik edhe nga ana e dizajnit. • Nxënësi reflekton dhe është në gjendje të përcaktojë se çfarë duhet të përmirësojë në projektet e mëtejshme. • Nxënësi dallon avantazhet dhe disavantazhet që ka ndeshur gjatë punës në grup me nxënësit e tjerë.
3	Mirë	7-8	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi përmbush një pjesë të konsiderueshme të rezultateve të të nxënit. • Nxënësi, përgjithësisht është i përkushtuar në punën për realizimin e projektit. • Nxënësi, përgjithësisht është i përgatitur në çdo fazë të projektit dhe ka kryer mirë pjesën më të madhe të veprimtarive të planifikuara. • Nxënësi e prezanton produktin e realizuar duke kërkuar herë pas here konfirmimin e anëtarëve të grupit ose të mësuesit. • Nxënësi jep disa informacione, shpjegime, diskuton, jep disa shembuj në varësi të natyrës së produktit të realizuar, por zgjat disa kohën e përcaktuar të prezantimit. • Nxënësi ka të dokumentuar pothuajse plotësisht punën që ka bërë në kuadrin e realizimit të këtij projekti. • Nxënësi, përgjithësisht, ka realizuar një produkt të mirë dhe është përpjekur të bëjë edhe paraqitje estetike të tij.

			<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi reflekton dhe me ndihmën e mësuesit tregon çfarë do të përmirësojë në projektet e mëtejshme. • Nxënësi përgjithësisht ka punuar mirë në grup me nxënësit e tjerë.
2	Mjaftueshëm	5-6	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi përmbush disa prej rezultateve të të nxënit. • Nxënësi, bën përpjekje për të realizuar projektin, por kërkon ndihmë dhe mbështetje e vazhdueshme gjatë gjithë fazave të tij. • Nxënësi, ka kryer deri diku mirë disa prej veprimtarive të planifikuara. • Nxënësi prezanton vetëm me ndihmë produktin e realizuar. • Nxënësi jep pjesërisht informacione, shpjegime dhe shembuj nëse i kërkohen. • Nxënësi e ka të dokumentuar pjesërisht punën që ka bërë në kuadrin e realizimit të këtij projekti. • Nxënësi ka realizuar një produkt jo të plotë që lë për të dëshiruar edhe nga ana estetike. • Nxënësi nuk është i qartë se çfarë i duhet të përmirësojë në projektet e mëtejshme. • Nxënësi përgjithësisht nuk ka qenë aktiv në punën në grup me nxënësit e tjerë.
1	Dobët	4	<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi nuk përmbush kërkesat bazë të të nxënit.

			<ul style="list-style-type: none"> • Nxënësi nuk ka realizuar produkt ose nuk ka dhënë kontribut në punën e përbashkët të grupit ku ka qenë pjesë. • Nxënësi nuk jep informacione, shpjegime dhe shembuj edhe kur i kërkohen. • Nxënësi nuk ka dosje projekti.
--	--	--	---

Projekti do të shkruhet dhe prezantohet nga secili grup sipas formatit të caktuar më poshtë:

- Tema e projektit
 - Rezultatet e të nxënit
 - Tabela e planit të veprimtarive që ka realizuar secili grup me afatet dhe personat përgjegjës. Kjo tabelë lidhet edhe me detyrat që ka realizuar secili anëtar i grupit.
- Një shembull table e planit të veprimtarive paraqitet më poshtë:

Faza e parë		
Parapërgatitja për projektin		
Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtari i grupit
Përzgjedhja e temës së projektit		
Përcaktimi i shtrirjes dhe kohëzgjatjes së projektit		
Përcaktimi i rezultateve të të nxënit		
Përcaktimi i grupeve të punës		
Ndarja e detyrave në grup		
Përcaktimi i partnerëve të projektit		

Përzgjedhja e teknikave dhe instrumenteve për grumbullimin e të dhënave		
Përcaktimi i burimeve që do të shfrytëzohen		
Përcaktimi paraprak i produktit që do të realizohet		
Përcaktimi i mënyrës së prezantimit të produktit të projektit		
Faza e dytë Puna për projektin		
Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtari i grupit
Zbatimi i detyrave të përcaktuara		
Përgatitja e instrumenteve për të grumbulluar të dhënat (pyetësorë, intervista, vëzhgime, fotografime, regjistrime)		
Mbledhja e informacioneve të nevojshme		
Grumbullimi i të dhënave		
Sistemimi dhe përpunimi i të dhënave		
Strukturimi i produkt që do të realizohet dhe mënyra e prezantimit të tij		
Faza e tretë Prezantimi i produktit/gjetjeve të projektit		
Veprimtaria që do të realizohet	Afati	Anëtari i grupit

Përmbledhja e realizimit të projektit		
Prezantimi i gjetjeve dhe i konkluzioneve/Përshkrimi i produktit, i mënyrës së realizimit dhe i instrumenteve të përdorura		
Ndarja e sfidave dhe e vështirësive të ndeshura gjatë projektit		
Ndarja e emocioneve të përjetuara gjatë projektit		
Dhënia e përgjigjeve ose e informacioneve sipas pyetjeve apo kërkesave të dëgjuesve		
Vetëvlerësimi i punës së kryer		
Reflektimi për të ardhmen		

- Konceptet kryesore që janë përdorur gjatë zhvillimit të projektit.
- Përshkrimi i shkurtër i projektit.
- Gjetjet e projektit. (Gjetjet mund të paraqiten me mënyra të ndryshme: mund të shkruhen në një poster; mund të paraqiten në fletë formati dhe të prezantohen vetëm me gojë, mund të prezantohen me mjete audio-vizuale, me program kompjuterik poëer point, nëse është produkt, prezantohet produkti etj.)
- Konkluzionet e projektit.

6.3.6 Vlerësimi i nxënësve dhe reflektimi

Për vetëvlerësimin e nxënësve merret në konsideratë:

- Vetëorientimi dhe vetëdrejtimi i nxënësve në grup.
- Përdorimi i burimeve të ndryshme të mbledhjes së informacionit.
- Gjetja e zgjidhjeve në situata të ndryshme dhe arsyetimet e pranueshme.
- Gjuha dhe terminologjia e përdorur, referuar edhe përdorimit të koncepteve lëndore.
- Përzgjedhja e teknikave, mënyrave dhe strategjive të përshtatshme.
- Angazhimi i secilit nxënës në realizimin e projektit, individualisht dhe në progresin e grupit.
- Mënyra e prezantimit të projektit, i cili të lexohet, të dëgjohej dhe të kuptohet qartë.
- Rezultatet e projektit, nëse janë të qarta dhe të kuptueshme.

Vlerësimi *i të* nxënësve të nxënësve realizohet nëpërmjet Vlerësimit periodik dhe Vlerësimit përfundimtar.

6.4 Plotesimi i vlerësimit periodik në regjistër

1. Vlerësimi periodik është dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të nxënësve për secilën periudhë. Ai përmban 2(dy) nota:
 - a. *Notën e vlerësimit të vazhduar,*
 - b. *Notën e vlerësimit me test ose me detyrë përmbledhëse.*
2. Këto dy vlerësime me notë shënohen në regjistër në kolonat përkatëse.

6.5 Nota përfundimtare vjetore

1. Vlerësimi përfundimtar realizohet me notë, në përfundim të vitit shkollor.
2. Nota përfundimtare vjetore përmbledh notat vjetore si më poshtë:
 - a) *Notën vjetore të vlerësimit të vazhduar për tri periudha.*
 - b) *Notën vjetore të vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse për tri periudha.*
 - c) *Nota e vlerësimit të projektit.*
3. Peshat në përqindje sipas vlerësimeve janë:

	<i>Pesha në përqindje klasat IV-V</i>
<i>Vlerësimi i vazhduar</i>	45%
<i>Vlerësimi me test/detyrë përmbledhëse</i>	30%
<i>Vlerësimi i projektit kurrikular</i>	25%

4. Hapat për njehsimin e notës përfundimtare vjetore janë:
 - a) Nota vjetore e vlerësimit të vazhduar (NVv) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit të vazhduar të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.
 - b) Nota vjetore e vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse (NTp/Dp) përcaktohet duke u bazuar në tri notat e vlerësimit me test/detyrë përmbledhëse të periudhave, duke gjykuar në mënyrë progresive.

c) Nota e vlerësimit të projektit (NVp) përcaktohet në përfundim të projektit duke u bazuar në procesin e realizimit të projektit dhe në produktin përfundimtar.

d) Shumëzohet secila prej notave me përqindjen përkatëse. Mblidhen këto prodhime dhe shuma rrumbullakoset me numër të plotë (p.sh., 8,8 ≈ 9).

e) Formulatat për llogaritjen e notës përfundimtare janë:

$$\text{Nota përfundimtare} = (NV_v \times 0.45) + (NTp/Dp \times 0.30) + (NV_p \times 0.25)$$

f) Dokumentimi në regjistër i rezultateve të vlerësimit të të nxënësve sipas periudhave është si në tabelën më poshtë:

Periudha e parë		Periudha e dytë		Periudha e tretë		Vlerësimi vjetor			Nota përfundimtare
NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _v	NTp/Dp	NV _p	
6	6	8	7	8	7	8	7	9	8

$$(8 \times 0.45) + (7 \times 0.3) + (9 \times 0.25) = 8$$

$$3.6 + 2.1 + 2.25 = 7.95$$

Nota përfundimtare: 8

6.6 Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar

Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuar mbështetet në realizimin e Planit Edukativ Individual. Mbështetur në Planin PEI, mësuesi ndihmës përshtat detyra dhe veprimtari me qëllim që nxënësit të kenë përparim dhe të përmbushin rezultate të nxënësve.

Si veprimtari mësimore, ashtu edhe teknikat e vlerësimit duhet të përshtaten në përputhje me planin PEI dhe të diskutohen vazhdimisht me prindërit e këtyre fëmijëve.

7 DREJT NJË MËSIMDHËNIEJE EFEKTIVE

Në punën mësimore, përdorimi i metodave çon në realizimin e qëllimeve dhe të detyrave edukative dhe arsimore. Metodatat ndërvepruese ndikojnë edhe në formimin e personalitetit të nxënësve, duke i aftësuar dhe përgatitur ata për jetë dhe për punë. Përzgjedhja e metodave/teknikave gjatë procesit mësimor është etapë shumë e rëndësishme e organizimit të orës mësimore. Mësimdhënia dhe të nxënësve të bazuar në kompetenca kërkon që në përzgjedhjen dhe përdorimin e strategjive, teknikave dhe metodave të mësimdhënies, mësuesi:

- të nxisë të menduarit kritik, krijues, dhe zgjidhjen e problemeve;
- të motivojë nxënësin, duke e konsideruar si partner, në kuptimin që në procesin mësimor mësuesi dhe nxënësi janë komplementarë të njëri-tjetrit;
- të mbështesë të nxënësit e pavarur dhe në bashkëpunim të nxënësve përmes punës me projekte, punës në grup, punës individuale;
- të mbajë parasysh integrimin dhe marrëdhënien ndërmjet lëndëve të arsimit fillor;
- të përdorë TIK-un si mbështetës dhe lehtësues të mësimdhënies dhe të nxënësve;
- të nxisë vëzhgimin dhe eksplorimin e drejtpërdrejtë të nxënësve, kureshtjen, arsyetimin dhe gjykimin nëpërmjet demonstrimeve, vëzhgimeve në natyrë dhe eksperimenteve.

Kriteret të cilat na ndihmojnë në përzgjedhjen e metodave/teknikave mësimore, janë:

- lënda mësimore;
- përmbajtja lëndore;
- natyra e orës së mësimin;
- etapa e organizimit të punës mësimore gjatë orës mësimore;
- mosha dhe shkalla e zhvillimit psikofizik të nxënësve;
- numri i nxënësve në klasë;
- forma didaktike e organizimit të punës mësimore;
- koha në dispozicion për përdorimin e metodave, teknikave dhe strategjive mësimore;
- pajisja e shkollës me bazë materiale për organizimin e punës mësimore në klasë;
- aftësia profesionale dhe pedagogjike e mësuesit dhe e bashkëpunëtorëve mësimorë.

Metodat ndërvepruese lidhen me të nxënit aktiv dhe promovojnë një mësimdhënie më cilësore që mbështetet në elemente të ndryshme të mëimit problemor, kërkimor, ku nxënësit udhëzohen të punojnë në grupe apo në mënyra individuale. Metodat ndërvepruese të organizimit të mëimit janë karakteristikë e metodave bashkëkohore.

Metodat që nxisin dhe zhvillojnë të menduarin kritik dhe krijues të nxënësve i përkasin një numri shumë të madh. Ato mund të grupohen në mënyra të ndryshme, në varësi të fokusit dhe qëllimit të tyre. Mund të përmendim këtu:

1. metoda të zhvillimit të aftësive lexuese;
2. metodat e zhvillimit të aftësive shkruese;
3. metoda të aktivizimit të punës në grupe, të quajtura ndryshe metoda të të nxënit në bashkëpunim;
4. teknika e të pyeturit;
5. veprimtaritë stimuluese etj.

Stuhia e mendimeve është një teknikë, e cila u kërkon nxënësve të tregojnë gjithçka që dinë rreth një teme, ose ideje të veçantë, e cila nis t'u rikujtojë atyre njohuritë që kanë. Nxënësit nuk mendohen nëse idetë që u vijnë në mendje janë të drejta, ose të gabuara. Nxënësit mund të punojnë në mënyrë individuale, ose në çift, në fillim duke i hedhur të gjitha idetë që kanë e, më pas, duke i shkëmbyer me anëtarët e tjerë të grupit. Mësuesi i hedh të gjitha idetë në dërrasën e zezë. Duke dëgjuar mendimet e të tjerëve, nxënësve mund t'u kujtohen gjëra të tjera ose mund t'u shtohet informacion i ri në kujtesën e tyre.

KLLASTERI ose grupimi i mendimeve që, në literaturë emërtohet " harta e mendimeve", ose edhe "pema e mendjes", është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë lirshëm dhe hapur rreth një çështjeje, i bën ata të mendojnë për të krijuar lidhje midis fakteve. Shërben si një mjet i fuqishëm për fillimin e procesit të të shkruarit, sidomos për ata nxënës që u mungon një dëshirë e tillë. Hapat për realizimin e kllastërit janë të thjeshtë dhe të lehtë për t'u mbajtur mend:

1. shkruhet një fjalë në qendër të fletës, (dërrasës së zezë, apo sipërfaqe ku mund të shkruhet);
2. shkruhen fjalë apo fraza që vijnë në mend rreth kësaj fjale apo teme të zgjedhur, pa gjykuar rreth tyre;
3. kur idetë vijnë në mend dhe shkruhen, fillohet të lidhen idetë me njëra – tjetrën;
4. shkrimi i ideve ndërpritet vetëm kur mbaron koha e caktuar. Ndërkohë nxënësit nuk duhet të shqetësohen për sforcimet në shkrim apo shqiptim.

INSERT³ është një metodë që i lejon nxënësit të kontrollojnë gjallërisht shkallën e tyre të të kuptuarit gjatë leximit. Nëpërmjet kësaj teknike sigurohet pjesëmarrje e qëndrueshme e fëmijëve në mësim. Gjatë leximit nxënësit udhëzohen që të vendosin shenjat e mëposhtme:

“√” vendoset shenja “√” (kontrollo), nëse diçka që lexoni pohon atë që dini ose mendoni se dini;

“+” vendosni një “+” (plus), nëse një pjesë e informacionit që ndeshni është i ri për ju;

“- ” vendosni një “ - ” (minus), nëse një ose disa prej informacioneve që lexoni kundërshton ose është e ndryshme nga ajo që dini ose mendoni se e dini;

“ ? ” vendosni një “?” (pikëpyetje), nëse ka informacion që është i paqartë për ju ose ka diçka që ju duhet të dini më shumë rreth këtij informacioni.

Informacioni i shenjëzuar, hidhet më pas në tabelën INSERT sipas shenjave përkatëse.

√	+	-	?

Di / Dua të di/ Nxë është një formë e ngjashme e teknikës INSERT është teknika “Di/Dua të di/ Nxë”, skema e të cilës është kjo:

Di	Dua të di	Nxë

në kolonën e parë, “Di”, nxënësit do të shkruajnë atë informacion që nga leximi u duket si i njohur;

në kolonën e dytë, “Dua të di”, do të shkruhen pyetje, ose kërkesa të nxënësve, rreth çështjeve për të cilat ata kërkojnë të dinë më tepër;

në kolonën e tretë, “Nxë”, nxënësit do të shkruajnë një përmbledhje të informacionit të ri që përvetësuan nga teksti.

³ Interactive Noting System for Effective Reading and Thinking

Pesëvargëshi⁴ është një poemë e cila kërkon sintetizimin e informacionit dhe materialeve dhe një shprehje të saktë, e cila përshkruan apo reflekton idenë kryesore të një teme të caktuar. Pesëvargëshi është një vjershë me pesë rreshta. Ai ka një strukturë të caktuar.

1. Rreshti i parë është përshkrimi me një fjalë i temës (zakonisht emër).
2. Rreshti i dytë është përshkrimi me dy fjalë i temës (dy mbiemra).
3. Rreshti i tretë përmban tri fjalë që shprehin veprime të temës (tri folje).
4. Rreshti i katërt është një fjali me katër fjalë që shpreh qëndrimin, ndjenjën për temën (fjali).
5. Rreshti i fundit është një fjalë sinonime, që ripërcakton thelbin e temës (sinonim).

Veprimtaria e të menduarit dhe të lexuarit të drejtuar – DRTA është një veprimtari, gjatë së cilës lexuesit nxiten të mendojnë e të parashikojnë rreth asaj që lexojnë. Fëmijët do të mendojnë gjatë kohës që lexojnë, do të parashikojnë dhe do t'i mbajnë shënim parashikimet e tyre. Ky aktivitet ndërtohet në bazë të tri pyetjeve: Ç’mendoni se do të ndodhë më pas? Çfarë provash keni? Si ndodhi në të vërtetë? Në mënyrë grafike organizohet në këtë mënyrë:

Ç’mendoni se do të ndodhë?	Çfarë provash keni?	Si ndodhi në të vërtetë?

Për të plotësuar tabelën, mësuesi bën pyetje, të cilat e përqendrojnë vëmendjen e lexuesve në titujt ose ilustrimet e zgjedhura. Mësimi mund të fillojë me një diskutim për **titullin e librit ose të historisë** dhe duke u bazuar në pyetjet: “Për çfarë mendoni se bën fjalë kjo histori / libër?” “Pse mendoni kështu?” Parashikimet shkruhen në ndarjen e parë të tabelës ose në dërrasën e zezë.

⁴ Rrjedh nga frëngjishtja (Cinquain) që do të thotë diçka e lidhur me numrin pesë.

Mësuesi duhet të pranojë të gjitha parashikimet e bëra nga ana e nxënësve. Pas këtyre diskutimeve fillestare, nxënësit do të lexojnë në heshtje historinë / tekstin, deri në momentet e përcaktuara që më parë nga mësuesi, për të nxjerrë pikat apo provat që tregojnë nëse parashikimet e tyre janë të sakta apo jo. Në këtë pikë, diskutimi vazhdon me parashikime të tjera të dhëna nga nxënësit, bazuar në leximin e tyre deri në këtë fazë. Këto veprime përsëriten derisa historia apo teksti të mbarojë.

Rrjeti i diskutimit është një teknikë e mësimdhënies gjatë së cilës bëhet organizimi grafik i informacionit, gjithashtu mund të "orkestrohet" një mësim i ndërlikuar. Kjo veprimtari i bën që nxënësit të jenë të vëmendshëm në leximin e tekstit për të kuptuar përmbajtjen dhe idenë kryesore të tij. Pjesëmarrja e nxënësve në këtë aktivitet është maksimale dhe argumentet e produktet e saj mjaft rezultative.

Mësuesi harton një pyetje binare (pyetje që pranon përgjigje pozitive, ose negative) që prek direkt thelbin e çështjes që trajtohet në tekst.

Po	Jo	<p>Ai u kërkon nxënësve që të argumentojnë pse janë pro, ose kundër çështjes duke i shënuar në organizuesin grafik. Mendimet do të shkëmbehen në dyshe e në katërshe. Klasa do të pozicionohet në dy grupe, ku nxënësit do të përcaktojnë pozicionin e tyre. Bëhet një raportim para klasës për arsyet që janë zgjedhur pro ose kundër çështjes. Për çdo paraqitje caktohet një kufi kohor prej një minute. Gjatë kohës që dy grupet raportojnë arsyet e tyre, nxënësit mund të ndryshojnë pozicion dhe të shkojnë në grupin që ka arsyet më bindëse.</p>
<p style="text-align: center;">A duhet të ...?</p>		

Rrjeti i diskutimit përdoret në fazën e realizimit të kuptimit, ose të reflektimit. Nga diskutimet që kryhen në klasë çdo nxënës kupton se cili është thelbi, çështja e mësimi, shkruajnë ese argumentuese dhe janë përfshirë të gjithë në diskutim.

Realizohet lëndë të tilla si lexim, histori, dituri etj. Grupet e fëmijëve duhet të jenë mbi 20 vetë. Diskutimi vazhdon për rreth 15 – 20 minuta. Mund të realizohet me nxënësit e çdo moshe. Zhvillimi i kësaj veprimtarie u siguron fëmijëve lirshmëri maksimale në dhënien e mendimeve, shprehje mendimesh me zë të lartë, shkrim argumentesh në favor të një çështjeje, përpjekje për të bindur kundërshtarët, lirshmëri në ndërrimin e vendeve gjatë debatit etj.

Ditarët e të nxënit janë ditarë dy ose tri pjesësh, që përdoren për të nxitur nxënësit të lexojnë në mënyrë të qëllimshme, të lidhin ngushtë materialin e tekstit me kureshtjen dhe përvojat e veta.

Citati	Komenti

Për të bërë ditarin dypjesësh, hiqet një vijë vertikale në mes të fletës së fletores. Në anën e majtë shkruhen ato pjesë të tekstit që i tërheqin më shumë vëmendjen nxënësit. Ndoshta ato që kujtojnë diçka, që i intrigojnë më shumë, ose ndoshta ato mendime dhe opinione me të cilat ata nuk pajtohen. Në anën e djathtë të fletës shkruhen komente për pjesën:


Pyetje ndihmëse për nxënësit janë:

- Ç ‘elementë kishte citati që i intrigoji më shumë?
- Ç'i bëri të mendonin ai citim?
- Çfarë pyetje lindin prej tij?

Gjatë leximit bëhen pushime për të shkruar të tjera citime dhe komente në fletore. Mund të caktohet edhe numri i citimeve që do të komentohen.

Ditari me tre pjesë është një formë tjetër ditari. Ai është i ndarë në tri pjesë. Kolona e fundit i lihet mësuesit për të vlerësuar, gjykuar dhe dhënë mendime mbi komentet që kanë bërë nxënësit.

Citati	Komenti i nxënësit	Komenti i mësuesit




Kubimi është një teknikë që ndihmon shqyrtimin e një teme nga këndvështrime të ndryshme. Ai përfshin përdorimin e një kubi me lëvizje të shpejta për të menduarin, të shkruarin në secilën faqe të kubit. Mund të ndërtohet duke mbuluar një kuti të vogël me letër. Në secilën faqe të kubit shkruhen 6 kërkesa, të cilat i përkasin çdo niveli pyetjesh: përshkruaj, krahaso, shoqëro, analizo, zbato, argumento (pro ose kundër).

Në fillim paraqitet tema. Më pas nxënësit udhëzohen të mendojnë dhe:

1. të përshkruajnë: Ç'formë ka? Cilat janë përmasat? Ç'ngjyrë ka?
2. të krahasojnë: Me kë ngjason? Nga se ndryshon?
3. të rikujtojnë ndonjë ngjarje a histori: Çfarë ju bën të mendoni? Çfarë ju vjen në mendje?
4. të analizojnë: Si është ndërtuar? Nga se përbëhet?
5. të zbatojnë në një situatë a kontekst të ri: Ç'mund të bëni me të? Si mund të përdoret?
6. të mbajnë një qëndrim të argumentuar ose të japin një zgjidhje të re: Cili është qëndrimi juaj? Pse?

Diagrami i Venit është një teknikë me anën e të cilës evidentohen të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet dy koncepteve, dukurive, historive, personazheve etj. Dy pyetjet mbi të cilat ndërtohet diagrami i Venit janë:

- Cilat janë të përbashkëtat ndërmjet ...?
- Po ndryshimet ndërmjet tyre?



Diagrami i Venit ndërtohet me ndërprerjen e dy a më shumë rathëve. Mund të përdoret për të bërë kontrastimin e ideve e duke treguar njëkohësisht të përbashkëtat që ato kanë me njëra - tjetrën.

Diagrami i Venit përdoret kryesisht gjatë fazës së përmbylljes së orës së mësimimit. Nëpërmjet tij, nxënësit zbulojnë tipare të përbashkëta, dallime midis koncepteve të ndryshme si dhe mbajnë qëndrime personale lidhur me to.

Përvoja ka treguar se është e mundur të përdoret në çdo lëndë, pothuajse në çdo orë mësimi. Veprimtaria zgjat 10-20', por është në varësi të specifikave lëndorë, moshave dhe të kohës së përgjithshme në dispozicion të orës së mësimit.

Puna në grupe ekspertësh është një teknikë që nxit punën në grupe të mëdha nxënësish 4-5 nxënës për çdo grup. Mësuesi e ndan klasën në grupe me nga katër pesë nxënës.

Çdo nxënës ka një numër 1,2,3,4,5. Pasi nxënësit kanë përcaktuar numrat bashkohen bashkë nxënësit me numrat 1, pastaj ata me numrat 2 e kështu me radhë. Mësuesi i jep secilit grup nga një detyrë të caktuar dhe punojnë duke u bërë ekspertë të çështjes për të cilën janë caktuar pasi kryejnë detyrën në grupet e reja që janë krijuar me njëshat, dyshat treshat e kështu me radhë kthehen dhe riformohen përsëri grupet bazë në të cilët çdo nxënës ka një detyrë specifike të cilën do ta prezantojë të gjithë se bashku marrin pjesë me pyetje dhe komente duke e qartësuar problemin deri në fund.

Zakonisht kjo teknikë përdoret kur punohen pjesë të gjata. Përmes kësaj teknike nxënësit përfshihen në shumë inteligjenca dhe shprehi të tilla si të lexuarit, të folurit, të shkruarit dhe kështu me radhë. Përmes kësaj teknike nxënësit përfshihen në marrëdhënie ndërvepruese me njëri-tjetrin.

Teknika RAFT është një teknikë e cila përdoret zakonisht për të kryer punë më shkrim në forma të ndryshme.

Nxënësit ndahen në grupe dhe u kërkohet që të shkruajnë për një temë të caktuar. Por jo të gjitha grupet shkruajnë në të njëjtën mënyrë.

Le të sjellim një shembull.

Tema e punës me shkrim është “Në ndihmë të fëmijëve të varfër”. Nxënësit do të ndahen në grupe prej 5 vetash.

Secilit grup, mësuesi u jep një detyrë.

- | | |
|-----------------------|--|
| Nxënësve të grupit 1. | Shkruani një ese me temë “Një botë pa skamje dhe varfëri për fëmijët”. |
| Nxënësve të grupit 2. | Shkruajini një letër presidentit të Amerikës me temë “NUK duam të shohim më fëmijë mes luftërave.”. |
| Nxënësve të grupit 3. | Rishikoni Konventën e të drejtave të fëmijës dhe bëni plotësime dhe ndryshime të neneve të saj. |
| Nxënësve të grupit 4. | Shkruani një tekst proteste për fëmijët që kanë braktisur shkollën. |
| Nxënësve të grupit 5. | Shkruajini një kërkesë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës për të gjetur mundësinë e arsimimit të fëmijëve të ngjuar. |

Të gjithë nxënësit brenda grupit do të shkruajnë në mënyrë të pavarur dhe kuptohet në mënyrë të ndryshme nga tjetri.

Mendo/ Puno në dyshe/ Tregoj tu tjerëve. Kjo teknikë i vë nxënësit të reflektojnë mbi tekstin dhe t’i japin formë mendimeve të tyre. Për realizimin e kësaj teknike, mësuesi shkruan ose përgatit më parë disa pyetje të hapura (me më shumë se një përgjigje) dhe kërkon nga nxënësit të japin përgjigje me shkrim.

Për të pasur përgjigje më të saktë nxënësit punojnë në dyshe dhe në përfundim çdo grup dysh përfaqësohet me një diskutim ku prezanton idetë e veta rreth përgjigjeve që u kanë dhënë pyetjeve.

Ruaje fjalën e fundit për mua. Kjo është një teknikë që i nxit nxënësit të mendojnë dhe të reflektojnë rreth leximit të një materiali. Hapat që ndiqen për realizimin e kësaj teknike janë:

1. Nxënësi do të zgjedhë në materialin që lexon një apo dy fragmente interesante.
2. Fragmenti i zgjedhur shkruhet në një skedë, duke shënuar edhe numrin e faqes nga është marrë.

3. Në anën e mbrapme të skedës shkruhet komenti, ose argumente pro ose kundër që ka ai rreth fragmentit të zgjedhur.
4. Nxënësi që thotë i pari fragmentin që ka zgjedhur, do ta lexojë komentin e tij të fundit, pas shokëve që kanë zgjedhur të njëjtin fragment.
5. Pasi lexohet edhe një herë ky fragment, mësuesi kërkon që nxënësit të bëjnë komente apo të reagojnë rreth fragmenteve të njëri-tjetrit. Mësuesi nuk përjashtohet nga shfaqja e mendimeve dhe ideve të tij.
6. Diskutimi përfundon duke ftuar nxënësit që e zgjedhi i pari fragmentin (Hapi 4) të bëjë komentin e tij.

Meqë ndiqet kjo procedurë, teknika quhet “Ruaje fjalën e fundit për mua”.

Në vijim ndiqet e njëjta procedurë me fragmentet e tjera.

Ese 5-10' dhe shkrime të lira përdoren si teknika të cilat i ndihmojnë nxënësit për të sistemuar mendimet e tyre gjatë të shkruarit. Në shkrimin e lirë, nxënësit shkruajnë pa u ndalur, pa e ndërprerë dhe pa u shqetësuar për gabimet drejtshkrimore. Shkrimet e lira të kësaj natyre e përgatisin nxënësit për veprimtari krijuese të shkruari. Ato shërbejnë si thesare krijimtarie individuale. Shumë mësues i pëlqejnë shkrimet e lira për t'i përdorur për zgjedhjen e ideve interesante për një ese të re që është duke ardhur, duke shmangur në këtë mënyrë ujërat që dalin shpesh nga nxënësit në punët e tyre me shkrim.

Tabela e koncepteve është një teknikë që shërben për të organizuar informacionin. Kjo tabelë është e rëndësishme kur punohet me tre ose më shumë gjëra njëkohësisht. Në këtë tabelë, renditen në rreshta gjëra dhe koncepte që krahasohen në tipare të ndryshme. Tabela e koncepteve ka forma të ndryshme. Formatimi i tyre varet nga konceptet apo tiparet që ata duan të krahasojnë.

Koncepti	Përkufizimi	Me çfarë shprehet	Funksioni	Pyetja me të cilën gjendet
1				
2				
...				

Personazhi	Tiparet	Dallimi	Pëlqimi	Mospëlqimi
P1				
P2				
...				

Rrjeti i diskutimit është një teknikë e përshtatshme për organizimin grafik të informacionit. Nxënësit duhet të jenë të vëmendshëm gjatë leximit të tij për të kuptuar përmbajtjen dhe idenë kryesore.

Po

A duhet që ...? Pse?

Jo

Mësuesi u drejton nxënësve një pyetje të hapur, e cila prek thelbin e çështjes që trajtohet në tekst. Nxënësit do të japin argumente pro ose kundër çështjes, të cilat do t'i shkruajnë në organizuesin grafik. Mendimet do të shkëmbehen në dyshe dhe në katërshe deri sa nxënësit të pozicionohen në dy grupe, duke mbrojtur pro ose kundër çështjes.

Gjatë kohës që të dy grupet raportojnë, nxënësit e tyre mund të ndryshojnë grup dhe të shkojnë te ai grup që ka argumentet më bindës.

Tryeza rrethore realizohet në një mënyrë krejt të thjeshtë.

- Merret një letër dhe një laps. Nxënësit janë ulur në mënyrë rrethore në grupe ose në një grup të madh.
- Zgjidhet krahu nga do të lëvizë letra dhe lapsi.
- Mësuesi kërkon që nxënësit të shkruajnë një ide rreth një problemi ashtu si ata mendojnë në atë moment për këtë problem.

- Letra dhe lapsi lëvizin nga njëri nxënës te tjetri.
- Çdo nxënës, pasi e shkruan idenë e tij, e palos letrën me qëllim që shoku pranë tij të mos e lexojë në atë moment.
- Dalëngadalë, letra merr formën e fizarmonikës. Mund të përdoren edhe lapsa me ngjyra të ndryshme, për të dalluar se kush e ka shkruar një mendim të caktuar. Pasi përfundon edhe nxënësi i fundit së shkruari, lexon komentimin e vet mësuesi.
- Kjo teknikë ndihmon shumë në realizimin e kuptimit të pjesës që punohet dhe gjen përdorim të gjerë në nxënësit e shkollës tetëvjeçare.
- Punimet e nxënësve varen në mur, ose lexohen nga secili ose nga mësuesi.
- Ndryshe kjo teknikë quhet edhe “Gushëkuqi rrethor” dhe mund të realizohet vetëm me të folur apo duke lexuar pjesë leximi njëri pas tjetrit.
- Kjo teknikë është e suksesshme, kur mësuesi e shoqëron me kërkesa të qarta, me pyetje motivuese dhe orientuese për debat.

8 LLOJET E PYETJEVE SIPAS NIVELIT TË TYRE

Sipas Taksonomisë së Benjamin Blumit aftësitë themelore të të menduarit klasifikohen në 6 nivele, duke i renditur në mënyrë hierarkike, nga niveli më i ulët deri te niveli më i lartë. Secili prej tyre i përkon një niveli të menduari. Sendërz (Sanders, 1996) i ka bërë një rishikim Taksonomisë së Blumit, duke i përshtatur pyetjet sipas niveleve të të menduarit. E rëndësishme është të kuptohet se çdo tip pyetjeje paraqet një mënyrë të menduarit. Edhe ato janë të vendosur në mënyrë hierarkike.

Pyetjet e nivelit riprodhues, janë ato lloj pyetjesh që kërkojnë rikujtimin e një informacioni të mësuar më përpara. Ato matin vetëm njohjen e fakteve nga ana e nxënësve, pa u thelluar më tej. Zakonisht këto janë pyetje të mbyllura që kanë vetëm një përgjigje. Pyetjet riprodhuese i përkasin nivelit më të ulët të të menduarit.

Pyetje tipike për këtë kategori janë:

- Në cilën datë?
- Kur ndodhi?
- Cili ishte?
- Kush janë personazhet? Cilat janë elementët? Cilët janë përbërësit?
- Ku vajti? Etj.

Pyetjet për të kuptuarit kërkojnë që nxënësit ta tregojnë/demonstrojnë atë që dinë nëpërmjet një ose disa formave shpjeguese. Ato i nxisin nxënësit të rindërtojnë apo ta përfytyrojnë informacionin në skena ose në imazhe, të cilat, më pas, nxënësit i tregojnë me zë të lartë. Është një proces që ngjall interesin e nxënësve për t'u përfshirë dhe për të dëgjuar versionet e shokëve të tjerë.

Pyetje të këtij niveli janë:

- Si u shëmbëllehet në mendje ajo që dëgjuat?
- Çfarë shihni?
- Si ndjeheni kur ...?
- Ç'skenë u del përpara? Etj.

Pyetjet interpretuese u kërkojnë nxënësve të zbulojnë lidhjet mes ideve, fakteve, ngjarjeve, përcaktimeve etj. Në bazë të këtyre lidhjeve zbulohet sa kanë kuptuar nxënësit nga informacioni i dhënë. Ata mund të krijojnë edhe kontekste të reja, në të cilat idetë dhe faktet përputhen.

Pyetje të tilla janë:

- Cila është ideja/ tema/ çështja kryesore?
- A mendoni se ...?
- Si mendoni ju, cila ishte ...?
- Pse mendoni kështu?

Pyetjet zbatuese ose pyetjet analizuese u kërkojnë nxënësve të bëjnë analizën e problemeve, t'i zgjidhin ato, duke patur parasysh faktet e dhëna. Nxënësit shpjegojnë nëse një ngjarje, ushtrim, problem është shpjeguar qartë, ose janë përgjigjet ato që do ta qartësojnë kuptimin. Për të dhënë përgjigje nxënësit do të mbështeten në informacionin e vlefshëm.

Pyetje analizuese janë:

- Cilat janë motivet e ...?
- Cilat janë arsyet/ faktorët që çuan në ...?
- Cili ishte plani i ...?
- A është dhënë në mënyrë të qartë?
- Çfarë do të ndodhë më tej?
- Si do të veprojmë më pas?

Pyetjet sintezë i nxitin nxënësit të jenë krijues në zgjidhjen e problemit, në dhënien e rezultatit, në nxjerrjen e përfundimeve, në kryerjen e detyrës etj. Për të dhënë përgjigje, nxënësit duhet të përdorin të gjitha njohuritë e marra, ose përvojën e tyre.

Pyetje sintezë janë:

- Si duhet të kishim vepruar ndryshe?
- A ka mënyrë tjetër për të zgjidhur çështjen?
- Po sikur të vepronim ... ç' do të kishte ndodhur?
- Ç' drejtim do të kishte marrë situata nëse ...?
- Cili do të ishte rezultati/ përfundimi?
- A ka përfundim tjetër?

Pyetjet vlerësuese u kërkojnë nxënësve të bëjnë gjykime rreth përcaktimeve “mirë”, “keq”, “e drejtë”, “e gabuar”, “e saktë” në përputhje me standardet që vendosin. Nxënësit kanë mundësinë të shprehin bindjet, opinionet e tyre bazuar në ato që kanë kuptuar, në raste të ngjashme dhe në përvojat e tyre. Nxënësit do të mbajnë qëndrimin e tyre personal, do të japin mendimet origjinale, do të gjykojnë sjelljen ose veprimin e një personazhi, do t'i japin ose jo të drejtë.

Pyetje të tilla janë:

- Cili është qëndrimi juaj në lidhje me ...?
- A veptoi mirë ...?
- A e zgjidhi drejt ...?
- Cilat janë anët pozitive? Po negative? Etj.

Hapat që duhet të ketë parasysh mësuesi për përdorimin e metodave ndërvepruese:

- Strukturimi i përmbajtjes së temës mësimore, planifikimi i orës së mësimi;
- Gjithëpërfshirja e nxënësve në orën e mësimi;
- Zbatimi i njohurive teorike me shembuj të situatave të jetës reale;
- Pjesëmarrja aktive e nxënësve në procesin mësimor;
- Transformimi i klasës në një mjedis të nxënësve aktiv;
- Përdorimi masiv i teknologjive.

Mësuesit për të zbatuar me efikasitet programin mësimor duhet të kenë aftësitë e duhura për të përdorur metodat bashkëkohore ndërvepruese në çdo orë mësimore.

8.1.1 Përparësitë e përdorimit të metodave ndërvepruese

a) Sigurimi i një përqendrimi të lartë të nxënësve në orën e mësimit.

Metodat ndërvepruese e bëjnë më interesante orën e mësimit dhe nxisin interesin dhe përqendrimin e nxënësve. Nëpërmjet ndërveprimit mundësojmë të përfshijmë në pjesëmarrje aktive edhe nxënësit që kanë probleme me sjelljen (nxënës hiperaktivë, nxënës me vështirësi në të nxënë).

b) Rritja e vlerësimit dhe e vetëvlerësimit.

Përdorimi i metodave ndërvepruese i bën nxënësit më të përgjegjshëm, pjesëmarrës aktivë në punën në grup, duke i bërë shumë bashkëpunues me njëri-tjetrin.

8.1.2 Roli i mësuesit gjatë përdorimit të metodave ndërvepruese në procesin mësimor

- Organizues i orës mësimore.
- Udhëheqës i procesit mësimor për drejtimin, orientimin dhe udhëzimin e nxënësve
- Partner me nxënësit gjatë komunikimit dhe ndërveprimit në klasë.
- Motivues për të siguruar progresin e secilit përmes një bashkëpunimi të suksesshëm.
- Vlerëson nxënësit dhe i motivon ato për të vetëvlerësuar veten e tyre.

8.1.3 Roli i nxënësit gjatë përdorimit të metodave ndërvepruese në procesin mësimor

- Planifikon detyrat e tij dhe merr përgjegjësinë për kryerjen e tyre brenda afateve të caktuara.
- Monitoron, vlerëson dhe rishikon planifikimet e tij për të përfunduar detyrat e ngarkuara dhe për të përmbushur qëllimet.
- Ndjek me përpikmëri udhëzimet që i jepen nga mësuesi.
- Pranon role të ndryshme dhe ndihet i barabartë me të gjithë gjatë kryerjes së punëve në grup.
- Pranon me pozitivitet idetë, opinionet, vlerat dhe traditat e të tjerëve.
- Shpreh aftësitë e tij për risi dhe është i gatshëm për të marrë përsipër detyra edhe përballë risqeve.
- Demonstron kureshtje dhe interes në mësim gjatë gjithë kohës mësimore.

- Identifikon, mbledh, vlerëson dhe përdor informacione të ndryshme, të cilat i shërbejnë si burime ndihmëse për kryerjen e detyrave.
- Ndërton marrëdhënie të shëndetshme në komunikimin me të tjerët.
- Zhvillon të menduarin kritik për të zgjidhur problemet dhe është i aftë për marrjen e vendimeve.
- Vlerëson dhe pasqyron në mënyrë kritike pikat e forta të tij.

Treguesit e veprimtarive të nxënësve në mësimdhënien ndërvepruese

Iniciativa e nxënësve është një tregues i qartë i veprimtarive të nxënësve

Iniciativa e nxënësve mund të manifestohet në mënyra të ndryshme dhe në faza të ndryshme të procesit mësimor. Është shumë e rëndësishme mënyra se si mësuesi i trajton iniciativat e nxënësve dhe gjithashtu reagimi i tij karshi tyre.

Pyetjet e nxënësve

Pyetjet e nxënësve gjatë zhvillimit të mësimin dhe veprimtarive në klasë janë forma të veçanta që flasin për iniciativat e nxënësve. Në mënyrë të veçantë pyetjet që nuk janë riprodhuese dhe informuese janë treguesi më pozitiv i aktivizimit të të menduarit të nxënësve

Vendimmarrja e nxënësve

Vendimmarrja e nxënësve është një tregues i dëshirës dhe varësisë karshi lëndës dhe në këtë sens është një tregues i vlefshëm i veprimtarisë. Vendimmarrja e nxënësve mund të ndodhë në dy situata të ndryshme: a) mësuesi qëllimisht bën një planifikim të tillë të mësimin që nxënësit janë vendosur në një situatë apo një dilemë në të cilën atyre iu duhet të marrin një vendim; b) kur nxënësit në mënyrë spontane shkojnë drejt një vendimi mbi atë se çfarë duhet të bëjnë, si ta bëjnë atë dhe se si të fillojnë një dialog rreth saj.

Sjelljet vlerësuese të nxënësve

Këtu është fjala për sjelljet vlerësuese të nxënësve për atë që është bërë dhe se si është bërë gjatë zhvillimit të mësimin, qoftë për vetë nxënësin, qoftë për nxënësit e tjerë apo mësuesin. Sjelljet vlerësuese janë tregues shumë të mirë të veprimtarive të nxënësve sepse ato

demonstrojnë qëndrimet personale të nxënësve, pëlqimin/mospëlqimin, vlerësimin e domethënies së tyre për nxënësit.

Reagimet emocionale

Reagimet emocionale janë një tregues i eksperiencës personale mbi atë se çfarë po ndodh gjatë procesit të mësimit. Ato janë të rëndësishme si një tregues i përgjithshëm i ndjenjave të nxënësve, por mund të jenë njëkohësisht tregues direkt për veprimtarinë e kryer gjatë mësimit. Këto reagime mund të jenë verbale ose jo verbale.

Reagimet psikomotore

Reagimet psikomotore mund të shfaqen në formën e gjesteve, ritualeve, kërcimit, imitimit, pozat e trupit (tendosja apo relaksimi) etj.

Produktet e krijuara gjatë veprimtarive

Produktet e nxjerra nga veprimtaria janë treguesi më i qartë dhe afatgjatë dhe një dëshmi se veprimtaria është kryer. Kjo tregon se sa e nevojshme është të analizosh shpeshtësinë e realizimit të këtyre produkteve, natyrën e tyre dhe një lidhje që ai ka me veprimtarinë e realizuar nga grupi gjatë procesit të të nxënit.

Karakteristikat apo lidhjet mes veprimtarive

Ky është një tregues kyç i një veprimtarie, përderisa qëllimi i të mësuarit dhe të nxënit ndërveprues është të zhvilluarit jo vetëm të një veprimtarie të vetme por të një veprimtarie që është vazhdim i një sërë veprimtarish të kryera nga nxënësit për të arritur rezultatet e të nxënit.

Ndërveprimi i nxënësve

Ky është padyshim treguesi më i qartë dhe më i drejtpërdrejtë që flet për përfshirjen e nxënësve në veprimtari.

Atmosfera e përgjithshme e grupit

Një atmosferë e përgjithshme psikologjike e një grupi gjatë realizimit të veprimtarisë mund të jetë një tregues direkt dhe indirekt për shkallën dhe cilësinë e procesit të nxënies.

DOSJA E NXËNËSIT

Në arsimin fillor, dosja e nxënësit ka për qëllim të përfshijë arritjet e nxënësit në veprimtaritë që kryen në klasë, në shtëpi, punimet gjatë projekteve, detyra krijuese, teste, detyra përmbledhëse, diktimit etj.

Në arsimin fillor, **është mësuesi ai që përcakton numrin dhe llojin e detyrave që bëhen pjesë e dosjes, duke u mbështetur në rubrikat e planifikimit sipas tri periudhave** “Për çfarë i vlerësojmë nxënësit” dhe “Rezultatet e të nxënësit sipas kompetencave të fushës/lëndës”.

Punimet dhe detyrat e përzgjedhura për në dosje janë mjete që i ndihmojnë nxënësit të zbulojnë anët e forta, dobësitë, mangësitë, vështirësitë dhe problemet që hasin gjatë procesit të punës. Ato dëshmojnë përparimin e nxënësve, aftësitë e tyre si dhe mundësitë për t’u përmirësuar më tej.

Mbajtja e dosjes personale dhe grumbullimi i materialeve është një mundësi e mirë edhe për prindërit për të njohur realisht përparimin e fëmijës së tyre, si dhe ku duhet të punojnë e t’i ndihmojnë më tej.

Dosja e nxënësit është një koleksion i qëllimshëm i punës së tij/saj, që tregon përpjekjet, arritjet, përparimin në një ose disa fusha apo lëndë. Zhvillimi dhe formimi i tyre nuk shfaqet vetëm në produktet përfundimtare. Ai është proces në vazhdim, që pasurohet çdo ditë.

Punimet që futen në dosje janë të larmishme dhe i japin mundësi çdo nxënësi të shfaqë dhe të tregojë çfarë di dhe çfarë është në gjendje të bëjë.

Punimet tematike, detyrat gjatë projekteve, hulumtimet e ndryshme dhe punimet individuale janë sa të orientuara nga mësuesi, aq edhe të zgjedhura nga vetë nxënësi që dëshmojnë interesin e tij për të nxënë dhe bashkëpunimin në grup. Ato janë dëshmi e kontributeve dhe talentit të nxënësit, me karakter hulumtues dhe krijues të tilla si punë praktike individuale, produkte të krijuara nga nxënësit, punime audio-vizuale, aktivitete në grup ose individuale, projekte individuale ose në grup etj.

Komunikimi i rezultateve te prindërit

Në fillim të çdo viti shkollor, mësuesi organizon një seancë informimi me prindërit, në të cilën u shpjegon mënyrën e vlerësimit të nxënësve, mënyrën se si do të organizohet ky vlerësim, ndihma që mund të japin prindërit, si dhe objektivat që priten të arrihen nëpërmjet realizimit të këtij vlerësimi. Pra, forma më e mirë për të informuar prindërit dhe për të qenë në kontakt të vazhdueshëm me ta është diskutimi në mënyrë të vazhdueshme në lidhje me atë çfarë kanë arritur apo po ndeshin vështirësi nxënësit.

Gjatë takimeve mujore me prindërit, mësuesit u vënë në dispozicion prindërve dosjen e fëmijës së tyre, duke dhënë edhe shpjegime, mbështetur në shënimet që ka mbajtur në fletoren etj.

Gjithashtu, shihet e rëndësishme dhe e arsyeshme që nxënësi të jetë pjesë e këtyre diskutimeve përveç rasteve ku prindi dhe mësuesit mendojnë që duhet të flasin pa praninë e tij.

9 TESTET

Testi është një vlerësim formal, përmbledhës, i strukturuar i arritjeve të nxënësit dhe i progresit të tij. Testet u lejojnë nxënësve të monitorojnë progresin e tyre dhe ofron informacion të vlefshëm për mësuesin në planifikimin e mëtejshëm të procesit mësimor. Ato ndihmojnë në nxënien e nxënësve nëse ato janë të lidhura qartë me mësimin dhe rezultatet e të nxënit. Dëshmitë tregojnë se testet e shkurtra janë më efektive për progresin e nxënësit se sa një test i gjatë. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që testet të korrigjohen dhe nxënësve t'u jepet informacion për ecurinë e tyre. Testet e hartuara në klasë zbulojnë rreth njohurive të nxënësve për përmbajtjen dhe për zhvillimin e të menduarit. Përgjithësisht pyetjet e hapura japin informacion më të detajuar në lidhje me aftësitë e nxënësve sesa një pyetje në të cilën ka vetëm një përgjigje.

9.1 Parimet e hartimit të testeve

Testet lejojnë shumëllojshmëri mënyrash të demonstrimit të aftësive të nxënësve prandaj:

- nxënësit duhet të kuptojnë qëllimin dhe vlerën e testit;
- testi duhet të masë arritjen e rezultateve të të nxënit për një kapitull ose periudhë të caktuar;
- duhen dhënë udhëzime të qarta për secilën pjesë të testit;
- pyetjet duhet të renditen nga më e thjeshta te ajo më komplekse;
- pikët duhet të jepen për çdo pyetje apo rubrikë të testit;
- pyetjet duhet të jenë të llojeve të ndryshme.

Testet:

- duhet të jenë të lehtë për t'u lexuar dhe të kenë hapësirë ndërmjet pyetjeve për të lehtësuar leximin dhe shkrimin;
- duhet të përfshijnë një sërë rezultatesh të nxëni;
- mund të kryhen edhe nga nxënësit me nevoja të veçanta;
- duhet t'u krijojnë mundësi nxënësve të zgjedhin kërkesat e ushtrimeve në mënyrë të pavarur nga njëra – tjetra;

- duhet të kenë nivele të ndryshme pyetjesh për të përfshirë mbledhjen, përpunimin dhe zbatimin e informacioneve;
- duhet të llogariten me kohë të mjaftueshme për të përfunduar të gjithë nxënësit;
- duhet të mos ngatërrohen me minitestet, të cilat masin rendimentin e orës së mësimin dhe kanë vetëm një kërkesë.

Gjatë ndërtimit të testeve të arritjes për një grup njohurish lëndore, mësuesi duhet të ketë në konsideratë:

- numri i pyetjeve në teste varet nga ajo çfarë do të testohet. Ky numër është i ndryshëm kur synohet testimi i përvetësimit të një koncepti, i përvetësimit të një mësimi, i përvetësimit të një kapitulli, i përvetësimit të lëndës së një periudhe etj.;
- pyetjet në test radhiten sipas shkallës së vështirësisë së tyre;
- numri i pyetjeve të testit varet edhe nga koha në dispozicion, kjo kohë mesatarisht duhet të jetë 45 minuta;
- gjatë hartimit të një testi është shumë e rëndësishme vlefshmëria e pyetjeve të tij (d.m.th. garantimi i asaj që testi në tërësi duhet të vlerësojë ato koncepte, njohuri, aftësi e shprehje që ne i kemi vënë vetes si qëllim të kontrollojmë).

9.2 Hartimi i testit

Hartimi i testit kalon në disa hapa.

Hapi i parë është përcaktimi i listës së koncepteve që do të testohen me peshën përkatëse (% e pikëve që do të zërë secili koncept kryesor në test), si dhe rezultatet e të nxënësve sipas kompetencave lëndore që do të testohen, diagnostikohen.

Hapi i dytë është përcaktimi i peshës së niveleve që do të zbatohet në test.

Tabela 21. Shpërndarja e peshave sipas niveleve për klasat I-III dhe IV-V

Klasat	Niveli II	Niveli III	Niveli IV	Niveli V
I-III	30-35 %	35-40 %	15-20 %	10 %
IV-V	35-40 %	35-40 %	15-25 %	-

Niveli i dytë i arritjes së kompetencave përfshin pyetje ku kërkohet që nxënësi të zbatojë një procedurë rutinë, mjaft të ushtruar në klasë. Niveli i tretë i arritjes së kompetencave përfshin pyetje ku nxënësi duhet të ndjehet para një situatë më komplekse, të cilën, do ta zgjidhë duke kombinuar njohuritë që disponon. Niveli i katërt dhe i pestë i arritjes së kompetencave përfshin pyetje ku nxënësi gjykon, zgjidh, jep mendim, vlerëson, krijon, harton duke vënë në dispozicion njohuritë e tij.

Hapi i tretë është ndërtimi i tabelës së specifikimeve (*blueprint-i*).

Tabela 22. Tabela e specifikimeve (Blueprint-i)

Konceptet	Përqindja e konvertuar në pikë	Rezultatet e të nxënit	Pesha e pyetjeve të nivelit II të arritjes së kompetencave	Pesha e pyetjeve të nivelit III të arritjes së kompetencave	Pesha e pyetjeve të nivelit IV ⁵ të arritjes së kompetencave
.....
Pikët total të testit	100% = ____ pikë	X %=____ pikë	Y %=____ pikë	Z% =____ pikë

Hapi i katërt është hartimi i pyetjeve të testit.

Pyetjet që mund të përdoren në test, janë:

- Pyetje me alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat). Një pyetje me alternativa përbëhet nga dy pjesë: trangu dhe përgjigjet alternative ndër të cilat dallohet përgjigja e vetme e saktë. Alternativat duhet të vendosen vertikalisht pas përmbajtjes së pyetjes, në përputhje me rendin alfabetik. Nuk duhet të përdoren alternativa që përplasen me njëra-tjetrën. Pyetjet ndërtohen në përgjithësi me 4 alternativa. Alternativat duhet të kenë gjatësi të njëjtë, duhet të jenë homogjene dhe t'i referohen të njëjtës kategori. Në alternativa nuk duhet të ketë mbivendosje të dhënash apo intervalesh kohore. Pyetjet me alternativë vlerësohen me një pikë. Ato shmangin në shkallë të lartë subjektivitetin në pikëzim.
- Pyetje me përgjigje: *E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/ E gabuar*. Përgjigja e saktë për këto lloj pyetjesh vlerësohet me një pikë.

⁵Për klasat I-III llogaritet edhe pesha e pyetjeve të nivelit V të arritjes së kompetencave.

- Pyetje me kombinime (me çiftim).Për çdo çiftim të saktë jepet një pikë, pra nëse ushtrimi ka 4 kombinime nga të dyja kolonat, nxënësi do të marrë 4 pikë, nga 1 për çdo kombinim të saktë.
- Pyetje me plotësimin e vendeve bosh me informacionin e duhur nga një përkufizim apo proces. Për çdo plotësim të saktë jepet një pikë.
- Pyetje me zëvendësim, zëvendësimi i një zgjidhje me të ngjashmen e saj. Për çdo zëvendësim të saktë jepet një pikë.
- Pyetje me përgjigje (zgjidhje) të shkurtër. Formulimi i tyre kërkon një përgjigje të përcaktuar e të përpiktë. Këto pyetje kërkojnë nga 1 deri në 5 minuta kohë për t'u lexuar e për t'u përgjigjur. Këtu hyjnë pyetje në të cilat nxënësit i kërkohet të bëjë një figurë, të kryejë një njehsim, të paraqesë shkurt një argumentim, të zgjidhë një ushtrim etj. Këto lloj pyetjesh kërkojnë më shumë se një miratim të thjeshtë ose një kujtesë mekanike. Ka më pak mundësi që nxënësit ta gjejnë përgjigjen me hamendje në krahasim me pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë.
- Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar. Këto lloj pyetjesh i kanë disa përgjigje të sakta, të cilat duhen gjetur nga nxënësit.
- Pyetje subjektive me përgjigje të zgjeruar. Këto lloj pyetjesh mund të kenë disa përgjigje të sugjeruara nga nxënësit. Në këtë rast vlerësohen argumentet që jep nxënësi dhe saktësia në arsyetimin e mendimeve dhe e veprimeve përkatëse.
- Si rregull në pyetjet me zgjedhje të shumëfishtë (1 pikë) *llogariten 60 sekonda*; për pyetjet e tjera për çdo pikë e dhënë llogaritet *90 sekonda*. Koha për përgjigjen e testit në tërësi përcaktohet paraprakisht duke mbajtur parasysh moshën e nxënësve, nivelin e shprehive të fituara nga nxënësit, shmangien e kopjimit prej tyre etj.
- Nëse gjatë testimit do të lejohet përdorimi i mjeteve si p.sh. makina llogaritëse, vizore, kompas etj., kjo duhet të përcaktohet më parë dhe të jepen udhëzimet sa dhe si do të përdoren ato.

Pyetjet duhet të jenë me një nivel të përshtatshëm vështirësie (kufiri i përshtatshëm është që 20% - 80% e nxënësve t'i përgjigjen saktë pyetjes).

Hapi i pestë është përcaktimi i skemës së vlerësimit (bazuar në shpërndarjen normale). Sistemi i pikëzimit që përdoret më shumë është ai që quhet analitik. Dy nga elementet bazë të këtij sistemi janë:

- caktimi i pikëve për konceptet që testohen;
- skema e pikëzimit (ku jepen kriteret e shpërndarjes së pikëve që janë akorduar për konceptet që do të testohen, duke pasur parasysh për bazë përgjigjen e saktë që duhet të jepet për këtë çështje).

Në konvertimin e pikëve me nota, kufiri i poshtëm rekomandohet 25% e totalit të pikëve.

Tabela 23. Intervalet e pikëve të testit për nivelet e vlerësimit në klasat I-III

Niveli	Niveli 1 APK	Niveli 2 ANP	Niveli 3 AK	Niveli 4 AShK	Niveli 5 ASh
Përqindja e përgjigjeve të sakta	0-24	25-51	52-64	65-90	91-100

Tabela 24. Intervalet e pikëve të testit për notat 4 – 10, në klasat 4-5

Nota	4	5	6	7	8	9	10
Përqindja e përgjigjeve të sakta	0-24	25-38	39-51	52-64	65-77	78-90	91-100

10 PËRGATITJA E NXËNËSVE PËR VANAF

Programi orientues për “Vlerësimin e Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor” përfshin konceptet, njohuritë, aftësitë dhe shprehjet më të rëndësishme që duhet të zotërojnë nxënësit në Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre në përfundim të arsimit fillor. Parë në këndvështrimin profesional, ky test nxjerr në dukje sa punën e mësuesit të arsimit fillor, po aq edhe formimin e nxënësit në ekto tri lëndë kryesore. Njohuritë dhe aftësitë që përmban Programi orientues në këto tri lëndë orientojnë mësuesin e arsimit fillor të punojë në mënyrë sistematike përgjatë pesë viteve të arsimit fillor dhe, gjithashtu, të përdorë modele ushtrimesh dhe kërkesash që e familjarizojnë nxënësin me natyrën e testimit për “Vlerësimin e Arritjeve të Nxënësve të Arsimit Fillor”.

Në lëndën e **Gjuhës shqipe**, kompetencat lëndore që vlerësohen në test janë:

- Të lexuarit e teksteve letrare dhe jo letrare (*nxënësi dallon temën, mesazhin dhe idetë kryesore në tekste të ndryshme letrare dhe jo letrare; analizon elemente të thjeshta në një tekst, si: përmbajtja, personazhet, mjedisi ose hapësira ku zhvillohen ngjarjet etj.; dallon gjuhën e figurshme nga gjuha jo e figurshme*).
- Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale (*nxënësi shkruan tekste të ndryshme duke u përqendruar në temën që do të trajtojë duke lidhur logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre*).
- Përdorimi i drejtë i gjuhës (*nxënësi dallon dhe përdor drejt lloje të ndryshme fjalish; dallon dhe përdor drejt gjymtyrët kryesore të fjalisë; dallon kategoritë gramatikore kryesore të emrit, foljes, mbiemrit, përemrit, si dhe gjen lidhëzat dhe para-fjalët; dallon fjalët e parme dhe jo të parme, si dhe pjesët përbërëse të fjalëve; dallon dhe përdor sinonimet dhe antonimet*).

Në lëndën e **Matematikës** kompetencat lëndore që vlerësohen në test janë:

- Zgjidhja e situatës problemore (*nxënësi përcakton të dhënat e situatës problemore; modelon një situatë problemore; zbaton hapa të ndryshme për zgjidhjen e situatës problemore; interpreton zgjidhjen e situatës problemore; paraqet zgjidhjen e situatës problemore*).
- Arsyetimi dhe vërtetimi matematik (*nxënësi identifikon elementet e situatës matematikore; përdor konceptet matematikore dhe proceset e përshtatshme për*

situatën e dhënë; arsyeton për zbatimin e koncepteve dhe proceseve në situatën e dhënë).

- Lidhja konceptuale dhe të menduarit matematik (*nxënësi përdor terminologjinë dhe përkufizimet matematikore; përdor dhe interpreton saktë konceptet dhe simbolet matematikore; kryen me saktësi procedurat standard*).
- Modelimi matematik (*nxënësi kryen modelime në gjuhën matematike; gjen zgjidhje matematike; përkthen zgjidhjen matematike në zgjidhje të situatës në jetën reale*).

Në lëndën e **Diturisë së natyrës** kompetencat lëndore që vlerësohen në test janë:

- Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre (*nxënësi identifikon një problem ose përcakton një grup problemesh; vlerëson qasjen e vet dhe të të tjerëve*).
- Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore (*nxënësi përdor mjete, objekte dhe procedura të ndryshme shkencore në përputhje me situatat dhe mënyrat e përdorimit të tyre në to; vlerëson ndikimin e mjeteve, të instrumenteve dhe procedurave*).
- Komunikimi në gjuhën dhe në terminologjinë e shkencës (*nxënësi përdor efektivisht gjuhën e simboleve dhe të jetës së përditshme për të formuluar pyetje dhe për të argumentuar përgjigjet*).

Në mënyrë të përmbledhur për lëndët Gjuhë shqipe, Matematikë dhe Dituri natyre, jepen njohuritë kryesore në të cilat duhet të punojë më shumë mësuesi i arsimit fillor, si dhe shkathhtësitë dhe aftësitë e nxënësve që demonstrojnë shkallën e përvetësimit dhe të përdorimit të këtyre njohurive.

Në lëndën e Gjuhës shqipe, njohuritë dhe shkathhtësitë kryesore për kompetencat gjuhësore që do të vlerësohen janë:

10.1 GJUHË SHQIPE

1. Të lexuarit e teksteve letrare dhe joletrare

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Tekste letrare: poezi, këngë popullore, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, romane për fëmijë.</p> <p>Nxënësi merr njohuritë e mëposhtme:</p> <ul style="list-style-type: none">• Renditja e ngjarjeve në një tekst.• Tiparet kryesore të teksteve letrare.• Tema ose çështjet kryesore.• Analiza e thjeshtë e përmbajtjes, mjedisit dhe kohës në një tekst.• Analiza e thjeshtë personazhesh duke u bazuar në fjalët, tiparet e jashtme dhe veprimet e tyre.• Epiteti, krahasimi.• Rima dhe strofa në një poezi.	<p>Të lexuarit për të kuptuar tekstin</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• përdor disa strategji për të kuptuar tekstin (<i>para, gjatë dhe pas leximit</i>);• parashikon se çfarë do të ndodhë në tekst duke u bazuar në atë që ka lexuar më parë;• u përgjigjet pyetjeve rreth brendisë së tekstit;• tregon brendinë e pjesës që lexon;• përmbledh idetë kryesore duke i ilustruar me fragmente dhe detaje nga teksti;• lidh idetë dhe informacionin e tekstit me njohuritë, përvojën dhe leximet e mëparshme ose dukuri të jetës së përditshme;• krahason në një tekst dy ose më shumë ide, koncepte, detaje etj.;• dallon disa elemente të formës së teksteve dhe sqaron funksionin e tyre;• zbulon ngjashmëritë dhe ndryshimet mes teksteve të ndryshme që trajtojnë të njejtën tematikë. <p>Të lexuarit e teksteve letrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• lexon tekste letrare, si: poezi, këngë popullore, fabula, tregime, novela, legjenda, përralla, romane për fëmijë;

	<ul style="list-style-type: none"> • u përgjigjet pyetjeve Kush? Çfarë? Kur? Ku? Pse? në lidhje me ngjarjet që ndodhin në tregim, përrallë, fabul, legjendë etj.; • dallon temat ose idetë kryesore në tekstet letrare; • tregon pjesën që i pëlqen më shumë dhe është më e këndshme për të, si dhe argumenton pëlqimin e tij/saj; • analizon brendinë dhe mjedisin ose hapësirën ku zhvillohen ngjarjet në një tekst; • analizon personazhet duke u mbështetur në fjalët, përshkrimet dhe veprimet e tyre; • gjen në një tekst rimën, krahasimin dhe epitetin.
<p>Tekste jo letrare: fletë ditari, udhëzime të shkurtra, sqarime, letra, njoftime, artikuj në revista për fëmijë etj. (të plota ose fragmente).</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tema ose çështjet kryesore. • Tipare të thjeshta të një udhëzimi, një letre etj. 	<p>Të lexuarit e teksteve joletrare</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • lexon tekste joletrare, si: <i>udhëzime të shkurtra, sqarime, njoftime, letra, pjesë ditari, artikuj në revista për fëmijë etj.</i>; • dallon temën ose idetë kryesore në tekstet joletrare; • analizon strukturën e një teksti të thjeshtë joletrar.

2. Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përshkrime të shokëve, artistëve ose sportistëve të preferuar etj. • Rrëfime ngjarjesh rreth botës reale dhe imagjinare, si p.sh.: për pushimet, për librat, për universin, për lojërat etj. • Përshkrime të thjeshta personazhesh. 	<p>Të shkruarit si proces - Planifikimi, organizimi, rishikimi dhe redaktimi i të shkruarit</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan duke u përqendruar në temën që do të trajtojë dhe lidh logjikisht fjalitë në paragraf dhe paragrafët mes tyre; • mbështet idetë me shembuj të ndryshëm; • shton, në një tekst, një dialog mes personazheve, një ndodhi të re, një paragraf etj.; • zbaton rregullat e drejtshkrimit gjatë të shkruarit; • rishikon tekstin që shkruan për të gjetur fjalët, shprehjet ose fjalitë e papërshtatshme dhe për t'i plotësuar ato me të tjera <p>Të shkruarit për qëllime personale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan natyrën, vendlindjen, fëmijërinë e tij/saj etj.; • përshkruan personazhet duke pasqyruar ndjenjat, mendimet dhe paraqitjen e jashtme të tyre; • rrëfen ngjarje, shpreh ndjenja, përcjell ide rreth botës reale dhe asaj imagjinare; • shkruan një hyrje ose një mbyllje ndryshe të një tregimi, përralle etj.;

	<ul style="list-style-type: none"> • krahason dy personazhe, ngjarje, mjedise nga një tregim, përrallë, fabul, roman për fëmijë etj., duke konkretizuar me shembuj dhe me ilustrime nga teksti; • shpreh me shkrim ndjenjat dhe përjetimet që i ngjall një poezi, një tregim etj.
<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shkrime njoftimesh të shkurtra. • Shkrimi i një letre drejtuar një miku ose një të afërmi. • Shkrimi i një flete ditari. • Shkrime ftesash për miqtë dhe shokët. 	<p>Të shkruarit për qëllime funksionale</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shkruan letra, ftesa, ditar, njoftime etj.; • shkruan duke respektuar strukturën e tekstit që përfshin hyrjen, zhvillimin dhe mbylljen; • respekton formën ose modelin e përshtatshëm, p.sh., gjatë shkrimit të një letre ose një njoftimi shkruan formulimet e hapjes e të mbylljes dhe nënshkrimin.

3. Përdorimi i drejtë i gjuhës

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Njohuritë për klasën e pestë</p> <p>a) Sintaksë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjalja si njësi leksiko-gramatikore, logjike dhe me intonacion të përfunduar. • Ndarja e fjalive sipas kumtimit. Veçoritë e tyre. • Grupi foljor dhe grupi emëror në fjali. 	<p>a) Sintaksë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • ndërton drejt fjali, duke pasur si bazë fjalën si njësi leksiko-gramatikore, logjikën e thënies, intonacionin e përfunduar; • heq, shton ose zhvendos fjalë në fjali, pa e prishur kuptimin e saj; • ndërton dhe dallon fjali dëftore, pyetëse, dëshirore, nxitëse;

<ul style="list-style-type: none"> • Gjymtyrët kryesore. Kallëzuesi. Kryefjala, me çfarë është shprehur. 	<ul style="list-style-type: none"> • dallon rendin e fjalëve në fjalitë dëftore dhe pyetëse; • dallon grupin foljor dhe grupin emëror; • dallon kryefjalën e shprehur me emër, përemër ose numëror; • formon fjali ku kryefjala të jetë e shprehur me emër, përemër ose numëror.
<p>b) Morfologji</p> <p>Emri</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kategoritë gramatikore të emrit. <p>Mbiemri</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbiemri i nyjshëm dhe mbiemri e panyjshëm. • Gjinia, numri dhe rasa e mbiemrit. Përshtatja e mbiemrit me emrin që shoqëron. <p>Përemri</p> <ul style="list-style-type: none"> • Lakimi i përemrit vetor. • Përemri pronor. • Përemri pyetës (<i>Kush? Cili? Çfarë Ç’? Sa?</i>). <p>Folja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tri zgjedhimet e foljeve. • Zgjedhimi në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme i foljeve <i>kam</i> dhe <i>jam</i>. 	<p>b) Morfologji</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • krahason emrat e përgjithshëm me emrat e përveçëm; • përcakton trajtën e emrit; • lakon emrat sipas rasave; • përcakton gjininë dhe numrin e emrit; • përcakton trajtën, rasën, gjininë dhe numrin e mbiemrit; • përshtat mbiemrin me emrin që shoqëron; • dallon dhe lakon përemrin vetor; • dallon përemrin pronor; • dallon dhe përdor përemrat pyetës (<i>Kush? Cili? Çfarë? Ç’? Sa?</i>); <ul style="list-style-type: none"> • përcakton zgjedhimin e foljeve; • zgjedhon në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme foljet <i>kam</i> dhe <i>jam</i>; • zgjedhon në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme, foljet e rregullta;

<ul style="list-style-type: none"> • Zgjedhimi në kohën e tashme, në kohën e kryer të thjeshtë, në kohën e pakryer dhe në kohën e ardhme, i foljeve të rregullta. <p>Ndajfolja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndajfolja, llojet. 	<ul style="list-style-type: none"> • dallon dhe përdor në fjali ndajfoljet.
<p>c) Fjalëformim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Fjalët e parme dhe fjalët jo të parme. • Pjesët përbërëse të fjalës. 	<p>c) Fjalëformim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • dallon fjalët e parme nga fjalët jo të parme; • dallon dhe analizon pjesët përbërëse të fjalës
<p>ç) Drejtshkrim</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i shenjave të pikësimit në fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore. • Përdorimi i shkronjës së madhe tek emrat e përveçëm dhe në rastet e tjera, si: emërtimet e rrugëve, të institucioneve etj. 	<p>ç) Drejtshkrim</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor drejt shenjat e pikësimit në fjalitë dëftore, pyetëse, nxitëse, dëshirore; • vendos saktë shenjat e pikësimit në dialog; • përdor shkronjën e madhe në fillim të fjalisë, tek emrat e përveçëm dhe në rastet e tjera.
<p>d) Leksikologji dhe semantikë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kuptimet e fjalëve. • Sinonimet dhe antonimet. 	<p>d) Leksikologji dhe semantikë</p> <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përcakton kuptimet e fjalës në kontekstin e dhënë; • krijon çifte sinonimie dhe antonimie; • dallon dhe përdor në fjali sinonimet dhe antonimet, për të përmirësuar gjuhën e folur dhe të shkruar.

10.2 MATEMATIKË

Njohuritë dhe aftësitë kryesore për kompetencat matematikore që do të vlerësohen.

1. TEMATIKA: Numri

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Numrat natyrorë, dhjetorë dhe të plotë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vendvlera e secilës shifër në numrat pesë-gjashtëshifrorë. • Kuptimi i numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta). • Rrumbullakimi i numrave katërshifrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt. • Rrumbullakimi i një numri dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt. • Krahasimi dhe renditja e numrave deri në një milion duke përdorur simbolet e krahasimit < dhe >. • Rënditja dhe krahasimi i numrave pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit. • Rënditja e numrave dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton vlerën e secilës shifër në numrat pesë-gjashtëshifrorë dhe i ndan në mijëshe, qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe; • përdor kuptimin e numrit dhjetor me dy shifra pas presjes (e dhjeta, e qindta) dhe gjen vlerën për secilën shifër; • rrumbullakos numrat katërshifrorë në dhjetëshen, qindëshen dhe mijëshen më të afërt; • rrumbullakos një numër dhjetor me dy shifra pas presjes në numrin e plotë më të afërt; • krahason dhe rendit numrat deri në një milion duke përdorur simbolet e krahasimit < dhe >; • rendit dhe krahason numra pozitivë dhe negativë në një bosht numerik ose në shkallën e termometrit; • rendit numra dhjetorë me një shifër ose dy shifra pas presjes; • njeh shumëfisha të 5,10, 25, 50, 100 deri në 1000;
<p>Thyesat</p>	<p>Nxënësi:</p>

<ul style="list-style-type: none"> • Marrëdhënia ndërmjet $1/2$, $1/4$ dhe $1/8$; $1/3$ dhe $1/6$; $1/5$ dhe $1/10$; • Barazimi ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë, p.sh., thyesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat. • Thyestat më të mëdha se 1 dhe numrat e përzierë. • Renditja e numrave të përzierë në një bosht numerik. • Pjesa e një sasi në situata të thjeshta. 	<ul style="list-style-type: none"> • një marrëdhënie ndërmjet $1/2$, $1/4$ dhe $1/8$; $1/3$ dhe $1/6$; $1/5$ dhe $1/10$; • një barazimin ndërmjet thyesave dhe numrave dhjetorë, p.sh., thyesa gjysma, të dhjetat dhe të qindtat; • kthen një thyesë më të madhe se 1 në numër të përzierë, p.sh., $7/4$ në $1\frac{3}{4}$; • rendit numrat e përzierë në një bosht numerik; • njehson pjesën e një sasi në situata të thjeshta.
<p>Përqindja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Përqindja si numri i pjesëve ndër 100 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • kupton përqindjen si numri i pjesëve ndër 100 dhe njehson përqindje të thjeshta; • shpreh gjysmën, të dhjeta dhe të qindtat si përqindje.
<p>Raporti dhe përpjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Thyesa si raport ose përpjesëtim i thjeshtë 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor thyesën për të përshkruar një raport ose përpjesëtim të thjeshtë, p.sh., $1/5$ e rruazave janë të verdha.
<p>Mbledhja dhe zbritja</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mbledhja e më shumë se tre numrave dy-treshifrorë. • Mbledhja ose zbritja e dy numrave tre-katërshifrorë. • Mbledh ose zbritja e dy numrave dhjetorë me të njëjtën numër shifrash mbas presjes. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mbledh më shumë se tre numra dy-treshifrorë; • mbledh ose zbret dy numra tre-katërshifrorë; • mbledh ose zbret dy numra dhjetorë me të njëjtën numër shifrash mbas presjes.

<p>Shumëzimi dhe pjesëtimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Shumëzimi i numrave deri në 10000 me 10 ose 100. • Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifrorë. • Shumëzimi i dy numrave dyshifrorë. • Shumëzimi i një numër dhjetor me një shifër mbas presjes me një numër njëshifrorë. • Pjesëtimi i numrave treshifrorë me numër njëshifrorë (përfshirë edhe pjesëtimin me mbetje). • Shprehjet deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • shumëzon numrat deri në 10000 me 10 ose 100; • shumëzon dhe pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifrorë; • shumëzon dy numra dyshifrorë; • shumëzon një numër dhjetor me një shifër mbas presjes me një numër njëshifrorë, p.sh., $3,6 \times 7$; • pjesëton numrat treshifrorë me numër njëshifrorë (përfshirë edhe pjesëtimin me mbetje); • rumbullakos rezultatin në një pjesëtim për të zgjidhur një situatë problemore; • njehson rezultatin e shprehjeve deri në katër veprime përfshirë edhe kllapat; • zgjidh situata problemore duke përdorur veprimet dhe algoritmin e tyre.
---	---

2. TEMATIKA: Matjet

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Gjatësia dhe masa</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësitë standarde: km, m, cm, mm, kg, g. • Numrat dhjetorë gjatë matjeve. • Këmbime me njësi të ndryshme. • Rrumbullakimi i matjeve në njësinë më të afërt. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • zgjedh dhe përdor njësitë standarde për gjatësinë dhe masën; • këmben njësi të kilometrit, metrit, centimetrit dhe milimetrit, kilogramit dhe gramit për të kryer matje në situata praktike. • rendit matje me njësi të përbëra; • rumbullakos matjet në njësinë më të afërt; • zgjidh situata problemore nga jeta e përditshme ku përfshihen matjet.

<p>Koha</p> <ul style="list-style-type: none"> • Njësiti e kohës sekonda, minuta, ora, dita, muaji, viti. • Kalendari. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përdor njësiti e kohës: sekonda, minuta, ora, dita, java, muaji, viti; • llogarit intervale të thjeshta në orë, minuta dhe sekonda; • përdor kalendarin dhe llogarit intervalet e kohës në muaj dhe vite, në ditë dhe javë nga situata të jetës reale.
<p>Perimetri dhe syprina</p> <ul style="list-style-type: none"> • Perimetri i shumëkëndëshit të rregullt dhe jo të rregullt. • Njësiti e sipërfaqes cm^2. • Formula për syprinën e drejtkëndëshit. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • mat dhe njehson perimetrin e shumëkëndëshit të rregullt dhe jo të rregullt; • kupton që syprina matet me katrorin e njësisë së gjatësisë, p.sh., cm^2; • përdor formulën për syprinën e drejtkëndëshit.
<p>Vëllimi</p> <ul style="list-style-type: none"> • - Litri, mililitri. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • - njeh lidhjen ndërmjet litrit dhe mililitrit.

3. TEMATIKA: Gjeometria

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Gjeometria në plan</p> <ul style="list-style-type: none"> • Trekëndëshi dybrinjënjëshëm, barabrinjës dhe i çfarëdoshëm. • Drejtëzat paralele dhe pingule. • Këndet e drejtë, të ngushtë dhe të gjerë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon dhe përshkruan vetitë e trekëndëshave dhe i klasifikon dybrinjënjëshëm, barabrinjës dhe i çfarëdoshëm; • vizaton drejtëza paralele dhe pingule në figurat 2D; • kupton që këndi matet me gradë, mat këndet në 5^0 më të afërt;

	<ul style="list-style-type: none"> identifikon, përshkruan dhe vlerëson masat e këndeve duke i klasifikuar ata në kënde të drejtë, të gjerë dhe të ngushtë; mat kënde të vizatuara.
Gjeometria në hapësirë <ul style="list-style-type: none"> Kubi, kuboidi, cilindri, koni, sfera, prizmi, piramida 	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> dallon dhe emërton trupat 3D (kubi, kuboidi, koni, cilindri, sfera, prizmi dhe piramida); klasifikon trupat 3D sipas numrit të brinjëve, faqeve, kulmeve.
Shndërrimet gjeometrike <ul style="list-style-type: none"> Simetria. Drejtëza e simetrisë. Rrjeti koordinativ. 	Nxënësi: <ul style="list-style-type: none"> ndërton figura simetrike; lexon dhe vendos koordinatat në kuadratin e parë të rrjetit koordinativ.

4. TEMATIKA: Algjebra dhe funksioni

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<ul style="list-style-type: none"> • Kutiza si vendmbajtëse numrash në barazime me mbledhje të dy numrave me katër –pesë shifra. • Dallimi i ligjesisë dhe vazhdimi i një modeli konkret ose të vizatuar, sipas kësaj ligjësie. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjen numrin që duhet vendosur në kutizë në barazime me mbledhje ose me zbritje; • përshkruan dhe vazhdon një model duke numëruar sipas një ligjësie.

5. TEMATIKA: Statistika dhe probabiliteti

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Grumbullimi, organizimi, interpretimi dhe përpunimi i të dhënave</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçimi dhe klasifikimi i një grupi objektesh, sipas një ose dy cilësie të përbashkët. • Diagramet në shtyllë dhe grafikët me vija. • Moda. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • i përgjigjet një pyetjeje nga jeta e përditshme duke grumbulluar, zbuluar ose klasifikuar të dhëna në një listë ose tabelë; • përmbledh konkluzione në mënyrën e tij, duke identifikuar pyetje të tjera; • përdor piktogramin, tabelën e dendurive, diagramin shtyllë për të prezantuar rezultatet; • përdor intervalet me 2, 5, 10, 20 ose 100 njësi në diagramin shtyllë; • gjen modën në një grup të dhënash.
<p>Probabiliteti</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mundësitë që një ngjarje të ndodhë. 	<p>Nxënësi</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan mundësinë që një ngjarje familjare të ndodhë.

10.3 DITURI NATYRE

Njohuritë dhe shkathtësitë kryesore për kompetencat e fushës së shkencave natyrore që do të vlerësohen.

1. TEMATIKA: Diversiteti

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Njerëzit, kafshët dhe bimët</p> <ul style="list-style-type: none">• Ngjashmëritë dhe ndryshimet midis njerëzve.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• identifikon pjesët kryesore të bimëve si: rrënja, kërcelli/trungu, gjethja, lulja, fruti, fara;• identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet midis njerëzve;• dallon dhe emërton pjesët kryesore të jashtme të trupit të njeriut.
<p>Materialet</p> <ul style="list-style-type: none">• Klasifikimi i materialeve.• Vetitë magnetike të materialeve. <p>Vetitë e materialeve</p> <ul style="list-style-type: none">• Materialet natyrorë dhe materialet e prodhuar nga njeriu. <p>Gjendjet e lëndës</p> <ul style="list-style-type: none">• Lëndët dhe vetitë e tyre.• Përzierjet e lëndëve.	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• klasifikon materialet në bazë të vetive të tyre;• përshkruan mënyrën se si disa materiale magnetizohen dhe disa jo;• identifikon dhe klasifikon materiale të përbëra nga lëndë natyrore dhe ato të prodhuara nga njeriu;• identifikon dhe përshkruan dallimet ndërmjet lëndëve të lëngëta, të ngurta dhe të gazta;• krahason trupa të ndryshëm sipas gjendjes së tyre;• përshkruan përzierjen e lëndëve të ndryshme dhe ndarjen e tyre.

2. TEMATIKA: Ndërveprimet

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Gjallesat në mjedisin e tyre</p> <ul style="list-style-type: none"> • Mjediset lokale. • Përshtatjet në mjedis. • Ndikimi i mjedisit te bimët dhe kafshët. • Ndikimi i njeriut në mjedis. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • gjen mënyra me anë të të cilave mjediset lokale ndikojnë te bimët dhe kafshët që jetojnë aty; • jep shembuj për bimë dhe kafshë që jetojnë në habitate të ndryshme dhe diskuton për tipare me të cilat ata përshtaten me mjedisin ku jetojnë; • gjen mënyrat me të cilat veprimtaria e njeriut ndikon në habitate lokale dhe në kujdesin për mjedisin.
<p>Ndryshimet e materialeve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Tkurrja dhe bymimi i materialeve. • Tretja e materialeve në ujë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan mënyrën se si ndryshojnë materialet kur nxehen dhe kur ftohen; • identifikon materialet që treten në ujë dhe përshkruan aftësinë tretëse të tyre.
<p>Forcat</p> <ul style="list-style-type: none"> • Forca e shtytjes dhe tërheqjes. • Efektet e forcës në lëvizjen e trupave. • Fërkimi. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan: <ol style="list-style-type: none"> a. se forcat mund të shkaktojnë lëvizjen e trupave ose prehjen e tyre, b. se forcat, duke përfshirë fërkimin, mund të bëjnë trupat të lëvizin më shpejt, më ngadalë dhe t'u ndryshojnë atyre drejtimin e lëvizjes; • dallon ndikimin e ashpërsisë së sipërfaqes në lëvizjen e trupave mbi të.

3. TEMATIKA: Sistemet

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Njerëzit dhe kafshët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Proceset jetësore. • E gjalla dhe jo e gjalla. • Klasifikimi i gjallesave. • Grupet kryesore të vertebrorëve. <p>Sistemet te bimët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kërkesat e një bime për të jetuar. • Transporti i ujit te bima. <p>Sistemet te kafshët</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ushqimet. • Shqisat te njeriu. • Mbështetja dhe lëvizja: kockat e skeletit dhe muskujt. <p>Ilaçet</p>	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan proceset jetësore të përbashkëta te bimët dhe kafshët përfshirë të ushqyerit, lëvizjen, rritjen dhe riprodhimin; • përshkruan ndryshimet midis qenieve të gjalla dhe jo të gjalla duke përdorur njohuritë që kanë për proceset jetësore; • përshkruan si bimët dhe kafshët jetojnë (qëndrojnë gjallë); • ndan gjallesat në grupe duke përdorur dhe përshkruar tipare të thjeshta për t'i grupuar ato. • përshkruan: <ol style="list-style-type: none"> a) si uji thithet nga rrënjët e bimës dhe transportohet përmes kërcellit; b) se bimët kanë nevojë për rrënjë, kërcëj dhe gjethe që të rriten mire; c) rritja e bimës ndikohet nga temperatura; • përshkruan se si përmes shqisave njerëzit dhe kafshët njohin botën rreth tyre; • përshkruan se si kockat e skeletit rriten, mbështesin dhe mbrojnë trupin; • emërton kockat kryesore në trupin e njeriut.
<p>Elektriciteti dhe magnetizmi</p> <ul style="list-style-type: none"> • Qarku elektrik. • Elementët përbërës të qarkut të thjeshtë elektrik. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • identifikon elementët përbërës të një qarku të thjeshtë elektrik (pilë/burim, fije përcjellëse, llamba elektrike) dhe rolin e secilit prej tyre;

<ul style="list-style-type: none"> • Elektriciteti dhe përdorimet e tij. • Magnetet. • Polet magnetike të një magneti. • Vetitë magnetike të metaleve. <p>Toka dhe hapësira</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rrotullimi i Tokës rreth boshtit të saj. • Rrotullimi i Tokës rreth Diellit. • Sistemi diellor dhe yjet. 	<ul style="list-style-type: none"> • shpjegon se llamba ndriçon ose jo, kur hapim apo mbylлим çelësin; • shpjegon se një pajisje elektrike nuk punon në qoftë se ka shkëputje në qark; • shpjegon se ndriçimi i llambave në qark zvogëlohet, kur shtojmë numrin e llambave në të dhe anasjelltas; • ndërton skemën e një qarku të thjeshtë elektrik në seri, me (pilë/burim, tela lidhës dhe llambë); • dallon përcjellësit nga jopërcjellësit; • përshkruan karakteristikat e magneteve dhe përdorimin e tyre në jetën e përditshme; • përshkruan lëvizjen e Tokës dhe planetëve të tjerë në sistemin diellor; • përshkruan formimin e ditës dhe natës si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth boshtit të saj; • shpjegon formimin e stinëve si pasojë e rrotullimit të Tokës rreth Diellit; • shpjegon se Dielli është një yll në qendër të sistemit diellor.
---	--

4. TEMATIKA: Ciklet

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Cikli jetësor te bimët, kafshët dhe njeriu</p> <ul style="list-style-type: none"> • Riprodhimi te bimët. • Rritja dhe ndryshimi te bimët. • Rritja dhe ndryshimi te kafshët përfshirë dhe njeriun. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan kushtet që ju duhen bimëve dhe kafshëve për të jetuar; • jep shembuj se si çdo organizëm i gjallë rritet dhe riprodhohet; • jep shembuj se si insektet pjalmojnë disa lule;

	<ul style="list-style-type: none"> • jep shembuj se si bimët me lule kanë një cikël jetësor që përfshin pllenimin, formimin e farës, shpërndarjen e farës dhe mbirjen; • tregon se njerëzit dhe kafshët lindin pasardhës që kur rriten ngjajnë me prindërit e tyre; • përshkruan ndryshimet që pësojnë gjatë ciklit të jetës kafshë si pula, bretkosa, flutura, kafshë shtëpiake dhe njeriu.
<p>Ndryshimet e gjendjes së lëndëve</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ndryshimet e lëndëve gjatë ngrohjes dhe ftohjes. • Proceset e shkrirjes, ngrirjes. avullimit, kondensimit. • Qarkullimi i ujit në natyrë. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan shndërrimin e lëndëve dhe ndikimin e temperaturës në to; • përshkruan procesin e shkrirjes dhe të ngurtësimit; • përshkruan proceset e vlimit, të avullimit dhe të kondensimit të ujit; • përshkruan dhe shpjegon qarkullimin e ujit në natyrë, duke dalluar faktorët që ndikojnë në të.

5. TEMATIKA: Energjia

NJOHURITË	SHKATHTËSITË
<p>Tingulli</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burimet e tingullit. • Përhapja e tingullit. • Karakteristikat e tingullit. <p>Drita</p> <ul style="list-style-type: none"> • Burimet e dritës. • Drita dhe errësira. 	<p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshkruan se tingulli: <ul style="list-style-type: none"> a) përhapet nga një burim dhe në prani të një mjedisi lëndor; b) përhapet përmes materialeve të ndryshme lëndore (trupa të ngurtë, lëngje dhe gaze); c) dobësohet kur largohemi nga burimi që e prodhon atë;

<ul style="list-style-type: none"> • Hija dhe ndryshimet e saj. 	<ul style="list-style-type: none"> • jep shembuj të materialeve që nuk e lejojnë kalimin e tingullit përmes tyre; • jep shembuj të prodhimit të tingujve nga instrumentet frymorë; • identifikon burimet e ndryshme të dritës; • bën dallimin mes burimeve natyrore dhe artificiale të dritës; • shpjegon si përhapet drita në vijë të drejtë, por mund të ndryshojë drejtimin e saj; • përshkruan si formohet hija; • vrojton se hijet ndryshojnë pozicionin dhe madhësinë e tyre gjatë ditës; • shpjegon se: <ul style="list-style-type: none"> a) trupat e patejdukshëm nuk e lejojnë dritën të depërtojë; b) trupat gjysëm të tejdukshëm e lejojnë dritën të depërtojë pjesërisht; c) trupat transparentë e lejojnë dritën të depërtojë plotësisht; • tregon se drita pasi pasqyrohet bie në syrin tonë dhe ne shohim trupat; • shpjegon se sipërfaqet e ndritshme dhe të sheshta pasqyrojnë dritën; • shpjegon se sipërfaqet e ashpra e përthithin dritën; • tregon rrugën që përshkon rrezja rënëse nga burimi deri te syri ynë; • tregon si mbrohet syri nga drita e fortë e Diellit; • tregon se drita e bardhë përbëhet nga të gjitha ngjyrat e ylberit.
--	---

Pyetjet që duhet të përdoren nga mësuesi i arsimit fillor, që nga klasa e parë janë:

- Pyetje me alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat).
- Pyetje me përgjigje: E vërtetë/ E rreme; Po/Jo; E saktë/ E gabuar.
- Pyetje me kombinime (me çiftim).
- Pyetje me përzgjedhje konceptesh apo simbolesh.
- Pyetje me plotësimin e vendeve bosh me informacionin e duhur nga një përkufizim apo proces.
- Pyetje me zëvendësim, zëvendësimi i një zgjidhje me të ngjashmen e saj.
- Pyetje për modelimin e situatave nga jeta reale në një situatë matematikore ose nga shkenca.
- Pyetje me përgjigje të shkurtër ose me plotësim.
- Pyetje subjektive me përgjigje të kufizuar.
- Pyetje subjektive me përgjigje të zgjeruar.
- Pyetje që vlerësojnë vlefshmërinë e zgjidhjes së një situatë problemore.

11 SHTOJCA - MODEL PROJEKTI

PROJEKTI “NGJYRAT DHE TË DREJTAT E MIA

Problemi: Mësimi i të drejtave të fëmijës dhe shprehja e tyre nëpërmjet artit

Produkti: Ekspozitë figurative, album figurativ

Monitorues: Grupi i punës

Buxheti do të sigurohet nga kontributi i prindërve dhe i donatorëve që mund të gjenden.

Vendi: Holli i shkollës

Kohëzgjatja: 6 muaj

Qëllimet e projektit:

- Njohja e nxënësve me të drejtat e fëmijës, nëpërmjet veprimtarive praktike, situatave dhe rasteve nga jeta e përditshme.
- Krijimi i mundësive që çdo nxënës të përjetojë, të sjellë përvojë personale, të analizojë, të mbajë qëndrim, dhe të masë “temperaturën” e të drejtave të njeriut në mjediset ku jeton dhe mëson: në familje, shkollë, komunitet e më gjerë.

Rezultatet e projektit

Rezultatet e të nxënësve në lidhje me njohuritë. Nxënësi:

- Përcakton të drejtat që realizohen në mjedisin familjar, në shkollë dhe në komunitet.
- Përcakton përgjegjësitë personale në lidhje me të drejtat.
- Lidh situatat, tregimet, personazhet me të drejtat përkatëse të KDF-së.

Rezultatet e të nxënësve në lidhje me aftësitë. Nxënësi:

- Bashkëpunon me shokët dhe shoqet.
- Pranon mendimet dhe idetë e të tjerëve.
- Kryen me përgjegjësi për detyrat që i caktohen.

Rezultatet e të nxënit në lidhje me vlerat. Nxënësi:

- Respekton të tjerët.
- Shfaq vlera humane sipas rastit që i paraqitet.
- Ndihmon shokët që paraqesin vështirësi.

Rezultatet e të nxënit në lidhje me qëndrimet. Nxënësi:

- Mban qëndrimin e duhur në situata konfliktuale.
- I jep zgjidhje problemeve që dalin gjatë punës.

Materialet dhe mjetet

Konventa e të drejtave të fëmijës, letra dhe kartona vizatim i të bardhë dhe me ngjyra, lapsa, penela, akuarele, temperë, ngjitëse, shkumësa me ngjyrë, foto dhe figura që paraqesin raste të zbatimit ose të shkeljeve të të drejtave të fëmijëve.

Ecuria metodike e projektit

Nr.	Faza	Metoda e veprimitarisë			Periudha	
1	Faza e parë	Motivimi	Kërkimi	Zgjidhja	Janar- mars	
2	Faza e dytë	Krijimi		Shkëmbimi i informacionit	Prill-maj	
3	Faza e tretë	Vlerësimi në shkollë		Ekspozita	Botimi	Qershor

Motivimi

Përgatitet situata për të njohur nxënësit me projektin e ri që do të ndërmerret.

Nxënësit njihen me qëllimet dhe rezultatet e të nxënësve, të cilat për aq kohë sa do të zgjasë projekti do të mbahen të afishuara në muret e klasës.

Mësuesi u bën nxënësve një përshkrim të fazave të realizimit të projektit dhe të produktit që pritet në mbyllje të tij.

Nxënësve u kërkohet që të mbledhin materiale të ndryshme që lidhen me zbatimin ose me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe në veçanti të të drejtave të fëmijës.

Kërkimi

Njohja, të kuptuarit dhe zbatimi i të drejtave të fëmijëve ka lidhje të drejtpërdrejtë me procesin e edukimit. Të njohësh të drejtat nuk do të thotë që kjo mjafton për t'i zbatuar ato. Zbatimi i të drejtave në veprimtarinë e përditshme jetësore kushtëzohet nga shumë faktorë, megjithatë puna sistematike në këtë drejtim me nxënësit dhe me prindërit sjell rezultate pozitive.

Dokumentet kryesore për t'i njohur fëmijët me të drejtat e tyre janë broshura "Të drejtat e mia" për moshën 7-12 vjeç, KDF-ja, varianti i thjeshtuar ose i plotë i saj, botimi i Save the children për të drejtat e fëmijëve "Për fëmijët, nga fëmijët", manuali "Të gjithë jemi njerëz...", botim i UNESCO-s etj.

Grupet e punës

Nr.	Grupi	Detyra	Sasia	Drejtuesi
1	Grupi i parë	Hartimi i projektit	3 vetë	Mësuesi i klasës
2	Grupi i dytë	Sigurimi i bazës materiale		Kryetari i bordit të prindërve
3	Grupi i tretë	Punimi i neneve të KDF-së	3-4 veta	Prindër dhe specialistë nga OJF
4	Grupi i katërt	Koordinimi i veprimtarive		Prindër dhe artistë
5	Grupi i pestë	Menaxhimi i përgatitjeve të ekspozitës	3 vetë	Mësuesi i klasës
6	Grupi i gjashtë	Koktejl	3 vetë	Bordi i prindërve
7	Grupi i shtatë	Përgatitja e certifikatave	2 vetë	Bordi i prindërve
8	Grupi i tetë	Ftesat	7 veta	Bordi i prindërve
9	Grupi i nëntë	Juria	5 veta	Drejtori i shkollës
10	Grupi i dhjetë	Grupi i medias	2 veta	Prindërit

Zgjidhja e problemit

Ngritja e diskutimeve mbi bazën e materialeve dhe të mjeteve të siguruara, mbi bazën e personazheve dhe të karaktereve të dashura për fëmijë, si Hirushja, Luli i vocërr, rosaku i shëmtuar, fëmijë me aftësi të kufizuar, fëmijët romë, fëmijë të talentuar etj.

Punimi i çdo neni të KDF-së dhe lënia e detyrave pas çdo veprimtarie të tillë.

Detyrë 1. Kërkimi i momenteve nga jeta e përditshme e nxënësve dhe e fëmijëve të tjerë që lidhen me zbatimin e të drejtave të tyre

Detyrë 2. Grumbullimi nga burime të ndryshme informacioni për të drejtat e mohuara ose të shkelura të fëmijëve.

Krijimi

- Interpretimi i ilustrimeve të përdorura në librin e të drejtave të shkruara nga fëmijët për fëmijët, botim i “Save the Children, në libërthin “Të drejtat e mia“ të QSHDNJ, në manualin “Të gjithë jemi njerëz...”, botim i UNESCO-s, si dhe në fotot e gjetura prej fëmijëve.
- Lidhja me elementet dhe parimet e artit: figura, linja, ngjyrat, hapësira, kontrasti, raporti i përmasave, uniteti, harmonia, përdorimi i simboleve etj.
- Përgatitja nga ana e nxënësve e punimeve artistike në pikturë, skulpturë, kolazh etj., në bazë të të kuptuarit të të drejtave të fëmijëve.

Shkëmbim informacioni

- Organizimi i takimeve me specialistë dhe ekspertë në fushën e të drejtave të njeriut, me përfaqësues të organizatave që veprojnë në këtë fushë, me mësues me përvojë në edukimin e të drejtave, me nxënës që kanë dhënë kontributin e tyre në këtë drejtim etj.
- Diskutimi rreth kategorive të të drejtave të njeriut dhe rëndësisë së njohjes së tyre dhe përpjekjeve për minimizimin e rasteve të shkeljes së tyre.

Finalizimi i projektit

- hapja e ekspozitës me punimet më të mira të zgjedhura prej vetë fëmijëve;
- referime të anëtarëve të grupeve të punës;
- intervista me të ftuarit në këtë veprimtari;
- diskutime rreth çështjeve të ndryshme të të drejtave të fëmijëve, të shprehura në punimet e fëmijëve;
- shfletimi i librave për të drejtat;
- botimi i albumit me foto nga veprimtaria dhe puna e nxënësve gjatë projektit etj.

Plani për veprim

Qëllimi i projektit	Rezultatet e të nxënit	Veprimet	Përgjegjësit	Koha	Përparësitë	Treguesit	Monitoruesit
1. Edukimi për të drejtat e fëmijës	1.1. Njohja me problemin	1.1.1. Shtrimi i problemit në klasë 1.1.2. Diskutimi me prindërit 1.1.3. Takime me specialistë të artit dhe të të drejtave të fëmijës 1.1.4. Miratimi i projektit në shkollë	Mësuesi i klasës	J A N A R	Ndërgjegjësimi i fëmijëve dhe i prindërve për zbatimin e të drejtave të fëmijës. Gatishmëria e prindërve, anëtarëve të komunitetit dhe specialistëve për të kontribuar vullnetarisht në këtë projekt.	Realizimi i projektit në shkollë. Mbështetja nga prindërit në sigurimin e materialeve të nevojshme për ekspozitën e projektit.	Drejtoria e shkollës; Përfaqësuesi i bordit të prindërve; Vlerësues të jashtëm;
	1.2. Hartimi i projektit	1.2.1. Ngritja e grupit qendror 1.2.2. Përcaktimi i veprimtarive kryesore	Grupo i parë				

		1.2.3. Ndarja e detyrave					
	1.3. Paraqitja e projektit në grupet e interesuara	1.3.1. Diskutim me prindërit, drejtorinë dhe mësuesit e shkollës 1.3.2. Seanca trajnimi për punimin e materialeve të të drejtave të njeriut 1.3.3. Diskutimi për të drejtat e njeriut me grupet e interesuara	Grupi i dytë Grupi i tretë			Krijimi i grupeve të punës, sigurimi i kapaciteteve trajnuese.	
2. Të shprehurit nëpërmjet artit e interpretimeve rreth të drejtave të fëmijës.	2.1. Ndarja e detyrave	2.1.1. Parja dhe diskutimi i ilustrimeve në materiale të ndryshme që lidhen me të drejtat e fëmijës.	Grupi i katërt	Sh K U R T	Gatishmëria e specialistëve të artit dhe e miqve të klasës.	Motivimi i nxënësve.	

		<p>2.1.2. Gjetje të rasteve të moszbatimit të KDF-së në klasë, familje, komunitet</p> <p>2.1.3. Sigurimi i materialeve për ekspozitën</p>			<p>Përfshirja e një numri të madh njerëzish në projekt.</p> <p>Interes gjithnjë në rritje e komunitetit në këtë projekt.</p>	<p>Punimet e para të nxënësve.</p> <p>Përgatitja e materialit që do të hidhet në rrjetet sociale të shkollës.</p>	
	2.2. Hedhja e ideve në letër	<p>2.2.1. Vizitë në galerinë e arteve</p> <p>2.2.2. Ushtrimi i nxënësve në vizatime dhe punime të tjera artistike</p>	Grupi i pestë	M A R S			
	2.3. Shkëmbimi i informacioneve	2.3.1. Takime me ekspertë të drejtave të njeriut, me mësues e nxënës	Grupi i parë	P R I LL			

		<p>2.3.2. Ndhurma e nxënësve të klasës nga nxënësit më të rritur</p> <p>2.3.3. Përgatitja e materialit në rrjetet sociale</p>	Grupi i dhjetë				
<p>3. Sensibilizimi i opinionit për respektimin e të drejtave të fëmijës sipas KDF</p>	<p>3.1 Përgatitja e ekspozitës</p>	<p>3.1.1. Përgatitja e posterave dhe fletëpalosjeve</p> <p>3.1.2. Përgatitja e mjedisit ku do të zhvillohet ekspozita</p> <p>3.1.3. Përgatitja e ftesave për të ftuarit</p> <p>3.1.4. Përgatitja e certifikatave</p> <p>3.1.5. Marrja e masave për filmimin</p>	<p>Grupi i pestë</p> <p>Grupi i dytë</p> <p>Grupi i tetë</p> <p>Grupi i shtatë</p> <p>Grupi i dhjetë</p> <p>Grupi i nëntë</p>	<p>M</p> <p>A</p> <p>J</p>		<p>Hapja e ekspozitës.</p>	

		dhe fotografimin e veprimtarisë 3.1.6. Caktimi i anëtarëve të jurisë 3.1.7. Përgatitja e koktejlit	Grupi i gjashtë				
	3.2. Përgatitja për botim e albumit	3.2.1. Sigurimi i fotove për album 3.2.1. Shkrimi i komenteve që do të përfshihen 3.2.1. Faqosja e albumit	Grupi i dhjetë	M A J	Gjetja e donatorëve	Botimi i albumit.	
	3.3. Vlerësimi i projektit	3.3.1. Përgatitja e pyetësorëve për vlerësimin e projektit 3.3.2. Gjetja e një specialisti për	Grupi i parë	Q E R SH O	Nxjerrja në dukje e anëve të forta dhe e dobësive që kishin përgatitja e kësaj veprimtarie	Përgatitja e një raporti përfundimtar për këtë nismë të marrë.	

		<p>vlerësimin e projektit</p> <p>3.3.3. Mbledhja e komenteve nga prindërit, nxënësit, mësuesit e tjerë të shkollës, anëtarë të komunitetit dhe përfaqësues të OJF-ve të përfshirë në projekt.</p>		R			
--	--	---	--	---	--	--	--

Disa punime të nxënësve të marra nga ekspozita “Ngjyrat dhe të drejtat e mia”



Neni 3, 27 & 31



Neni 26 dhe 31



Neni 13 dhe 17



Neni 17, 28 dhe 31



Neni 2 dhe 19